

Silvana Nini

Faton Aliu

Libër për mësuesin/en

Art figurativ 6



Libër për mësuesin/en

Art figurativ 6



Librin për mësuesin mund ta shkarkoni në linkun: <https://www.botimepegi.al/>

ISBN: 978-9951-843-29-4



9 789951 843294

BOTIME



Silvana Nini

Faton Aliu

LIBËR PËR MËSUESIN/EN

ART FIGURATIV 6

Për klasën e 6-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2024



Lejohet për botim teksti shkollor për klasën e xxxx, me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nr.xxxxxxx

BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t: xxxxxxxxxx
Korrektore letrare: Oriada DAJKO
Paraqitja grafike: Aida ÇELA
Kopertina: Florinda ZONJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-843-29-4

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, maj 2024

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: cel: +355 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Sektori i shpërndarjes: cel: +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

PËRMBAJTJE

HYRJE	5
PLANI VJETOR	14
PLANI DYMUJOR: SHTATOR-TETOR	15
PLANI DYMUJOR: NËNTOR-DHJETOR	19
PLANI TREMUJOR: JANAR-SHKURT-MARS	24
PLANI TREMUJOR: PRILL-MAJI-QERSHOR.....	28
PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	33
REFERENCA	103

1. HYRJE

Arti figurativ ka të bëjë me materializimin e mendimit, ashtu si edhe me shprehjen e një realiteti social-kulturor. Që në fillimet e veta, njerëzimi e ka përdorur artin figurativ si një mënyrë për të përcjellë nëpërmjet imazhitbotëkuptimin e tij, duke përdorur aftësi që ndryshojnë në varësi të vendit, periudhës historike dhe kulturës. Mënyra se si na e përshkruan historia e artit praninë e imazheve artistike përgjatë shekujve, që nga parahistoria (përpara shfaqjes së shkrimit), na tregon për rëndësinë që kishin njohuritë artistike për njeriun. Këto njohuri dhe aftësi artistike kanë zënë rrënjë në ndjeshmërinë, intuitën dhe imagjinatën e tij. Artistët/et kanë kontribuar në zhvillimin e ideve dhe si rrjedhojë edhe të shoqërisë duke shprehur bindjet, vlerat dhe shqetësimet përmes veprave të tyre të artit. Në artin figurativ, imazhi mund të marrë forma të ndryshme, në varësi të mjeteve e të materialeve dhe teknikave të ndryshme artistike që përdoren për ta realizuar atë. Ai mund të jetë dy ose tredimensionalë, abstrakt ose figurativ, dinamik ose statik etj. Përzgjedhja e materialeve dhe organizimi i gjuhës pamore së një veprë varen nga mesazhi që ajo do të komunikojë. Edukimi, nëpërmjet lëndës së artit figurativ, nxit zhvillimin e përgjithshëm të nxënësit/es dhe pasuron kulturën e tij/saj. Kjo lëndë i ndihmon nxënësit/et të deshifrojnë mesazhet pamore, të vëzhgojnë imazhet me një ndjeshmëri më të lartë, të ushtrojnë mendimin kritik dhe ndjenjën estetike. Sot, në kulturën e edukimit i kushtohet shumë rëndësi pranisë së imazhit, dhe në këtë drejtim artet pamore luajnë një rol themelor në zhvillimin social dhe artistik të nxënësve/eve. Krijimtaria në art, kontribuon në formimin e identitetit personal, të vetëbesimit dhe ndihmon në krijimin e vetëdijes kulturore e të ndjeshmërisë artistike. Nxënësit/et kanë mundësi të krijojnë imazhet e tyre, duke u përfshirë në procesin krijues, duke zbuluar mundësi të shumta të kombinimit të materialeve me gjuhën pamore, për të komunikuar mendimin e tyre për një audiencë të caktuar.

1.1 Pse shërben ky libër?

Ky libër do t'u shërbejë mësuesve/eve të artit figurativ, të njohin dhe zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale në këtë lëndë, për zbatimin më së miri të risive në kurrikulën e artit pamor.

1.2 Çfarë synon ky libër?

Meqenëse arsimi po zbaton mësimdhënien bazuar në kompetenca, ky libër do të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjithë mësuesit/et e artit figurativ, të cilët/at do ta ndërtojnë punën e tyre të përditshme bazuar në njohjen e dokumentacionit të ri: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë e arteve, programi mësimor, dhe vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes së kompetencave në arte, të cilat përkojnë me tri faza mjaft të rëndësishme:

- a) *planifikimin e të nxënit;*
- b) *metodologjinë e mësimdhënies;*
- c) *vlerësimin e të nxënit bazuar në qasjen e re me kompetenca.*

Qëllimi i këtij libri është t'i orientojë dhe t'i ndihmojë mësuesit/et që japin mësim në klasën e gjashtë, për të përmbushur synimet e kurrikulës së artit figurativ, për ndërtimin e kompetencave lëndore, të fushës dhe kyçe të nxënësit/et e klasës së gjashtë, për të planifikuar dhe realizuar detyrat e tyre si mësimdhënës të kësaj lënde, në përputhje me dokumentet zyrtare e me fazat nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

1.3 Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me draft-programin e klasës së gjashtë, të shkallës së tretë të lëndës "Arti figurativ".

Ky libër merr përsipër:

- të sqarojë çdo mësues/e të artit pamor për të gjitha çështjet e planifikimit, të metodologjisë dhe të vlerësimit që duhet të zbatojë çdo mësues/e në lëndën e tij;

- të prezantojë dokumentet e hartuara dhe mënyrën se si ato duhet të përdoren nga vetë mësuesi/ja në lëndën e artit figurativ;
- të udhëzojë për të gjitha formatet e reja: planin vjetor, dymujor, ditor, situatat e të nxënësve etj., me të cilat duhet të punojë mësuesi/ja gjatë një viti shkollor.

Ky libër në parim jep, ofron ose sugjeron modele, por nuk i dikton ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxënësve, metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim.

Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

2. KOMPETENCAT KYÇE DHE ARTI FIGURATIV

Fjala kompetencë ka filluar të zbatohet tashmë në mjediset mësimore. Kompetencat shprehen nëpërmjet rezultateve të të nxënësve, duke dhënë qartë rolin që ato kanë në përdorimin dhe në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave kontekstuale në të cilën zhvillohet njohuria e artit figurativ.

Domosdoshmëria e zotërimit të kompetencave i aftëson individët /nxënësit të bëhen të aftë dhe t'i përdorin ato përgjatë gjithë jetës.

Kompetencat kyçe janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Çdo mësues/e duhet të dijë pse shërbejnë 6 kompetencat kyçe, duke ditur sesi t'i zhvillojë dhe ndërtojë ato në kontekstin e lëndës së vet me nxënësit sipas formateve të përcaktuara. Këto kompetenca ndërtohen dhe arrihen përgjatë shkallës duke ndërtuar përmes një nxënësi/se që zotëron këto aftësi:

- Komunikues efektiv
- Mendimi kreativ
- Individ i suksesshëm
- Kontribuues produktiv
- Individ i shëndoshë
- Qytetar i përgjegjshëm

Mësuesi/ja duhet të kujdeset që përveç njohurive të artit figurativ, të zhvillojë domosdoshmërisht me nxënësit e tij/saj edhe kompetencat kyçe.

3. METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS SË ARTIT FIGURATIV

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënien e artit figurativ është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin pamor/artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimin të artit pamor do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë mjedisin vizual dhe krijojnë nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetence të caktuar nëpërmjet rezultateve të të nxënësve dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e artit pamor, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike. Çdo

përmbajtje dhe veprimtari mësimore në artin pamor, është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual/artistik në shumë aspekte. Mësimdhënia në artin pamor, synon gjithë përfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca; mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien dhe nxënien e integruar. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit pamor mban parasysh:

- kompetencat kyçe;
- ndërtimi i çdo njohurie dhe i çdo aftësie mbështetur në ato të mëparshmet;
- veprimtari praktike krijuese në artin pamor, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet pamore me situata të jetës reale;
- mjete dhe materiale konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- krijimi i qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së artit pamor dhe përdorimi i saj përgjatë gjithë jetës;
- bashkëveprimi mësues-nxënës gjatë procesit mësimor, duke qenë plotësues të njëri-tjetrit.

Mësimdhënës të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet, por ka të atillë që përqendrohen më shumë në të menduarit, te kujtesa, në të kuptuarit. Për të arritur suksese në procesin mësimor duhet patjetër që mësimdhënësi/ja t'i zbatojë stilet e të nxënësve, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënësve dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura. Stilet e të nxënësve, nëpërmjet metodave dhe teknikave të mësimdhënies përmbush detyra të rëndësishme të mësimdhënies dhe:

- ruajnë përfshirjen aktive;
- nxisin diskutimin e hapur;
- nxisin nxënësit të krijojnë dhe të bëjnë pyetjet e tyre;
- ndihmojnë në shprehjen e mendimeve të nxënësve;
- ruajnë motivimin e nxënësve për të mësuar;
- siguron një mjedis ku respektohen mendimet;
- krijon një shtresë për reflektim në atë që nxënësit vlerësojnë;
- shërbejnë si nxitje për ndryshim;
- japin shpresë për përfshirjen kritike të nxënësve;
- ndihmojnë mendimin kritik në nivele të larta e të ndërlikuara.

3.1 STILI I TË NXËNËSIT PAMOR

Është kur nxënësi/ja e përvetëson përmbajtjen mësimore me anë të shqisës së të parit. Në këtë rast, mësimi konkretizohet, duke përdorur mjete mësimore si: foto, harta, fotografi, grafikë, piktura, ngjyra, makete, ilustrime, vizatime, DVD (ku kemi dy lloj stilesh: pamore dhe dëgjimore) etj. Të nxënësve përmes të parit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi/ja ku kërkohet përqendrimi i nxënësve në:

- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të memorizuar apo për të kujtuar një objekt, ngjarje, personazh, një situatë të caktuar në kontekstin e temës mësimore.
- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të nxitur diskutimin apo për të verifikuar njohuritë e marra më parë.

Në stilin e të nxënësve pamor do të gruponim: Kujtesën pamore; Organizuesit grafikë (teknikat: Diagramin e Venit, Kllasterin, Hartën e të pyeturit, etj.

3.2 STILI I TË NXËNIT DËGJIMOR

Është kur nxënësi/ja e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së dëgjimit. Këta nxënës përvetësojnë më mirë dhe më lehtë njohuritë nëpërmjet bisedave, diskutimeve ku bëhen vlerësime, jepen mendime, përfundime, bëhen analiza etj. Të nxënit përmes dëgjimit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi/ja ku kërkohet përfshirja e nxënësve në:

- dëgjimin e shpjegimit të njohurive apo një situatë në kontekstin e temës mësimore;
- biseda dhe diskutime në grup për prezantimin e punëve të ndryshme;
- veprimtari që kërkon të folur të rrjedhshëm dhe të qartë.

Në stilin e të nxënit dëgjimor do të gruponim: Brainstorming; Diskutimi; Hulumtimi i orientuar.

3.3 STILI I TË NXËNIT KINESTETIK

Është kur nxënësi/ja përvetëson përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, duke vepruar, luajtur, eksperimentuar, vizatuar etj. Këta nxënës janë më të suksesshëm nëse:

- e prekin dhe e ndjejnë përmbajtjen mësimore;
- ndërveprojnë me shokët/et dhe mësuesin/en;
- ndërveprojnë me mjetet e punës;
- përdorin gjuhën e ndjenjave.


Në stilin e të nxënit kinestetik do të gruponim: Eksperimenti; Puna në grup; Hulumtimi i lirë dhe i orientuar; vlerësimi i veprave të artit dhe kritika e artit.

Të tria këto stile harmonizohen dhe ndihmojnë çdo mësimdhënës të planifikojë veprimtari të larmishme mësimore, duke përdorur mjaft teknika dhe metoda të mësimdhënies.

4. TEKNIKA TË MËSIMDHËNIES

4.1 Brainstorming (stuhi mendimesh)

Mësuesit mund të përdorin brainstorming si një strategji (metodë) e të menduarit, për të ndihmuar nxënësit të gjenerojnë pyetje, ide dhe shembuj dhe të zbulojnë një ide apo një temë qendrore (kryesore). Gjatë aplikimit të brainstorming, nxënësit ndajnë idetë që u vinë në mendje dhe i regjistrojnë këto ide pa bërë gjykime rreth tyre. Mësuesi/ja mund të përdorë këtë metodë gjatë prezantimit të temës (gjatë situatës së të nxënit), për të përcaktuar atë që nxënësit dinë dhe duan (ose duhet) të mësojnë dhe për të orientuar zhvillimin e mësimit dhe reflektimin. Brainstorming stimulon të menduarit rrjedhshëm dhe fleksibël dhe gjithashtu mund të përdoret për të aftësuar nxënësit në zgjidhjen e problemeve artistike.



4.2 DISKUTIMI

Diskutimi është një strategji bashkëpunimi përmes së cilës nxënësit shqyrtojnë mendimin e tyre, reagojnë ndaj ideve, përpunojnë informacionin dhe artikulojnë mendimet e tyre duke i shkëmbyer me njëri-tjetrin dhe me mësuesit. Diskutimi mund të përdoret për të qartësuar konceptet, idetë dhe informacionin. Theksi vihet në bisedën dhe dëgjimin e njëri-tjetrit. Nëpërmjet diskutimit, nxënësit mund të krijojnë lidhje midis ideve dhe përvojës dhe të reflektojnë mbi interpretime të ndryshme.

4.3 BISEDAT

Bisedat shoqërojnë pothuajse çdo temë që ka të bëjë me njohuritë dhe punën praktike që shoqëron këto njohuri. Nxënësit duhet të diskutojnë nën udhëheqjen e mësuesit/es për punët e tyre dhe të shokëve; si ata/ato kanë përdorur elementet e vizatimit me të cilat janë njohur, si i kanë vënë në shërbim të idesë, si i kanë përdorur elementet e tjera që kanë njohur më parë. Si mund ta realizonin më mirë punën e tyre. Të krahasojnë punët e tyre me atë të shokëve.

Të nxjerrin në pah problemet që iu kanë dalë gjatë punës, si i kanë kapërcyer ato ose si duhet ta përmirësojë punën e tyre për të arritur rezultatin e dëshiruar në punimet e tjera etj.

Të gjitha këto konkluzione, nxënësi/ja duhet t'i nxjerrë me ndihmën e mësuesit/es pasi ai/ajo është udhëheqësi/ ja i/e bisedës dhe nxitësi/ja i/e bashkëbisedimit.

4.4 EKSPERIMENTI

Eksperimentimi është një metodë thelbësore për artin pamor dhe përdoret shpesh për të bërë lidhjen midis konkretes dhe abstraktes. Eksperimentimi kërkon që nxënësit të hetojnë, testojnë, eksplorojnë, manipulojnë, zgjidhin problemet, marrin vendime dhe organizojnë informacione në mënyrë praktike. Eksperimentimi inkurajon gjithashtu nxënësit që të përdorin aftësitë bashkëpunuese në mënyrë efektive në interpretimin dhe komunikimin e gjetjeve. Eksperimentimi rrit motivimin, mirëkuptimin dhe përfshirjen aktive të nxënësve dhe mund të iniciohet nga mësuesi/ja ose vetë nxënësi/ja.

4.5 PUNA NË GRUP

Teknikat e punës në grup u mundësojnë nxënësve të punojnë si ekip për të arritur një qëllim të përbashkët mësimi. Për shembull, një grup nxënësish mund të punojnë së bashku për të krijuar një vepër arti ose për të realizuar një projekt artistik. Përveç produktit përfundimtar të prodhuar nga grupi, një aspekt i rëndësishëm i procesit të të mësuarit bashkëpunues është që çdo anëtar i grupit të shqyrtojë se si grupi funksiononte dhe të vlerësojë kontributin e tij ose të saj në procesin e punës në grup. Diskutimet, shënimet dhe vetëvlerësimi janë disa mënyra në të cilat nxënësit mund të reflektojnë mbi procesin e punës në grup dhe pjesën e tyre në të.

4.6 KUJTESA PAMORE

Kujtesa pamore është një proces që shërben për ta bërë një objekt, një ngjarje ose një situatë të dukshme në imagjinatën e nxënësve duke e ndërtuar nëpërmjet përshkrimit me fjalë ose duke përdorur një imazh. Mësuesit mund të përdorin imazhet, gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies, si një ushtrim për kujtesën dhe si një nxitës i rëndësishëm përpara krijimit të punimit. Mësuesit gjithashtu mund të përdorin një sërë stimulimesh pamore (p.sh., ilustrime, fotografi, riprodhime veprash arti, video, objekte reale, grafika) për të ndihmuar nxënësit në krijimin dhe realizimin e punimeve të tyre artistike nëpërmjet teknikave të ndryshme.

4.7 HULUMTIMI I ORIENTUAR

Kjo është një metodë mësimore në të cilën nxënësit përdorin mjetet dhe materialet sipas zgjedhjes së tyre. Mësuesi/ja vëzhgon dhe dëgjon ndërsa nxënësit po eksplorojnë dhe japin udhëzime sipas nevojës, duke përdorur informacionin e mbledhur nga vlerësimi. Për shembull, mësuesi/ja mund të parashtrijë një pyetje, që nxit një mendim më të thelluar ose të prezantojë një fjalor të ri.

4.8 HULUMTIMI I LIRË

Ky është një aktivitet kyç i mësimdhënies që iniciohet nga nxënësit, duke përdorur materialet artistike në klasë në mënyrat e zgjedhjes së tyre. Mësuesi/ja vëzhgon dhe dëgjon si pjesë të vlerësimit të vazhdueshëm ndërsa nxënësit po eksplorojnë (hulumtojnë) lirisht, dhe nuk e drejton eksplorimin, ashtu siç bën gjatë eksplorimit të orientuar.

4.9 ORGANIZUESIT GRAFIKË


Përdorimi i grafikëve si mbështetje është një strategji veçanërisht e fuqishme e mësimdhënies. Grafikët, të konsideruar si një çelës pamor, u mundësojnë nxënësve të kuptojnë marrëdhëniet midis elementeve dhe organizimit të tyre në mënyrë pamore dhe jo vetëm nëpërmjet gjuhës, duke e bërë më të shpejtë përthithjen e njohurive. Grafikët mund të përdoren për të regjistruar, organizuar, krahasuar, analizuar dhe sintetizuar informacionet dhe idetë. Ato mund t'i ndihmojnë nxënësit të lidhin njohuritë paraprake me konceptet e reja si dhe konsolidimin e kuptimit të tyre.

Shembuj të përdorimit të grafikëve janë: Harta e pyetjeve (realizimi), harta e mendimeve (kllasteri), (reflektimi), tabela e koncepteve (reflektimi), diagrami i Venit (përdoret gjatë reflektimit), afatet kohore (kryesisht në historinë e artit). Përdorimi i tabelave grafike është jashtëzakonisht i dobishëm kur kryhet fillimisht si një aktivitet brainstorming i klasës apo grupit. Organizatori grafik ofron një mënyrë për të mbledhur dhe paraqitur në mënyrë vizuale informacion mbi një temë që do ta bëjë atë më të kuptueshëm për studentët.

4.10 TEKNIKA: DIAGRAMI E VENIT

Diagrami i Venit është një teknikë, më anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve (elementeve të artit, teknikave artistike, periudhave të historisë së artit, veprave të artit të një periudhe, veprave të artit të periudhave të ndryshme, veprave të artit me të njëjtën tematikë, etj. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësim, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.

Veprimtaria zgjat 10'-20', por është në varësi të temës, moshës dhe kohës së përgjithshme në dispozicion.



4.11 TEKNIKA: KLLASTERI


Kllasteri ose grupimi i mendimeve ose “Harta e mendimeve”, është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, sidomos për nxënësit/et që u mungon një dëshirë e tillë.

Hapat për realizmin e kllasterit janë të thjeshta dhe të lehta për t’u mbajtur mend:

- Shkruhet një fjalë në qendër të fletës, (dërrasës së zezë, apo sipërfaqes ku mund të shkruhet).
- Shkruhen fjalë apo fraza që vijnë në mend rreth kësaj fjale apo temës së zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.
- Kur idetë vijnë në mend të kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.
- Shkrimi i ideve ndërpritet vetëm kur mbaron koha e caktuar. Ndërkohë nxënësit nuk duhet të shqetësohen për gabimet në shkrim apo në shqiptim.


Kjo teknikë mund të përdoret në fazën e evokimit dhe të reflektimit, në të gjitha lëndët dhe me çdo moshë nxënësish. Ai mund të përdoret për të stimuluar të menduarit, përpara se të studiohet pjesa ose për të bërë përmbledhjen e asaj që është studiuar.

Shembulli:



4.12 TEKNIKA: HARTA E TË PYETURIT

Është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të mësimit, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit. Harta e të pyeturit mund të përdoret me sukses në fazën e realizmit, të kuptimit dhe të reflektimit. Një hartë e të pyeturit mund të përdoret për të menduar rreth çdo lloji çështjeje ose teme, ose gjatë një mësimi për të gjallëruar diskutimin e nxënësve, për t’i mbajtur ata të interesuar rreth problemit dhe për të përmbledhur informacionin e trajtuar.



5. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Gjatë zhvillimit të mësimin në lëndën e artit figurativ, për realizimin e kompetencave, mësuesi/ja përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi/ja i prek, i shikon, i përdor etj. Ai/ajo përdor mjete pamore, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon ambiente për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në artin figurativ duke ndihmuar nxënësit/et të eksplorojnë vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit etj., si dhe duke zhvilluar aftësitë e tyre në studimin e kësaj lënde.

Mësuesi/ja përdor fjalë e fjali të qarta të sakta kuptimore dhe një fjalor të pasur të gjuhës artistike pamore. Mësuesi/ja siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai/ajo u prezanton/sqaron nxënësve/eve përmbajtjet e caktuara ose shkathtësitë që ata/ato duhet të performojnë.

Mësuesi/ja u krijon mundësi nxënësve që me anë të mediave të demonstrojnë apo prezantojnë detyra dhe projekte të ndryshme. Mësuesi/ja duhet të demonstrojë drejtpërdrejt gjatë mësimdhënies në lëndën e artit pamor. Për nxënësit e kësaj moshe është shumë e rëndësishme lidhja midis demonstrimit të mësuesit/es dhe dhënies mundësi të përdorimit të njohurive dhe aftësive të tyre në veprimtarinë artistike. Në këtë mënyrë, ata/ato do të krijojnë pavarësi në përdorimin e mjeteve nga një nivel në tjetrin. Kur mësuesit/es i duhet të përdorë kontekstin kulturor të artit, duhet të marrë në konsideratë të gjitha format e artit nga e gjithë bota dhe nga kultura të ndryshme. Programi i artit figurativ u jep të gjithë nxënësve mundësinë të zbulojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në përdorimin e një sere mjetesh dhe teknikash artistike, si dhe të vlerësojnë veprat e artit. Klasa duhet të jetë gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit në orën e artit. Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- Fotografi të ndryshme që mbajnë informacionin e duhur për eksplorimin e elementeve të artit në natyrë dhe mjedisin rrethues.
- Fotografi të objekteve të ndryshme të artizanatit, të trashëgimisë kulturore etj.
- Riprodhime të veprave të artit dhe postera.
- Mjetet audiovizive si: TV, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- Mjetet verbale, tekstet si: tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit/es, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve/eve dhe demonstruar vepra të ndryshme arti, artizanati, dizajni etj. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për artin figurativ. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et në punët e tyre krijuese.
- Mjedisi mësimor: (klasa, kabinetet e artit pamor etj.).

6. PLANI VJETOR

Fusha e kurrikulës: Arte Klasa: VI

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës
	Gjysmëvjetori i parë		Gjysmëvjetori i dytë		
	Shtator-Tetor 9 orë	Nëntor-Dhjetor 8 orë	Janar-Shkurt-Mars 11 orë	Prill-Maj-Qershor 9 orë	
		Elementet figurative (8 orë) Parimet e artit (1 orë)	Parimet e artit (3 orë) Ekspozita dhe aktivitete kulturore (1 orë) Krijimi i punimeve (4 orë)	Krijimi i punimeve (8 orë) Periudha historike (3 orë)	
					Komunikues efektiv I. 1, 2, 4, 6. Mendimi kreativ II. 1, 3, 4, 5, 6, 7. Nxënës i suksesshëm III. 1, 3, 5, 7, 8. Kontribues produktiv IV. 3, 4, 7. Individ i shëndoshë V. 2, 4, 5. Qytetar i përgjegjshëm VI. 1, 6, 8.

PLANI DYMUJOR: SHTATOR-TETOR

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA MËSIMORE: ARTI FIGURATIV KLASA: VI

TEMA MËSIMORE: Elementet figurative

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT- KOMUNIKUES EFEKTIV

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMI KREATIV

II.1 Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.

1.3 Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

1.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESHËM

III.1 Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

13 Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.

14 Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

V.2 Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative në mjedisin e tij ose në rrethinë.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

VI.6 Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.

REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN III:

2.1 Përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta.

2.3 Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre.

4.2 Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.

TEMA MËSIMORE: Parimet e artit

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT- KOMUNIKUES EFEKTIV

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMI KREATIV

II.1 Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESHËM

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

IV.4 Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

V.2 Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative në mjedisin e tij ose në rrethinë.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

VI.6 Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.

REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN III:

1.2 Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura.

1.3 Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre.

4.2 Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
Elementet figurative Parimet e artit	- Njeh, përshkruan dhe përdor elementet dhe parimet e gjuhës figurative. - Dallon dhe përdor lloje të ndryshme të vijave për të realizuar punime artistike. - Prezanton dhe përshkruan punimet e tij, para klasës. - Dallon lloje të ndryshme të formave dhe realizon punimin duke përdorur elementin e formës. - Krijon vepra artistike duke përdorur lloje dhe teknika të ndryshme të vizatimit. - Dallon llojet e ngjyrave dhe aplikon ato në punimet artistike.	Perceptimi pamor Shenja dhe pika Vija Forma dydimensionale Ngjyra Tekstura Vëllimi Hapësira Kompozimi dhe parimet e tij. Baraspesha	9 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Brainstorming Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike	Teksti shkollor Softuerë arsimorë Imazhe ilustruese CD

	- Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike. - Përdor lloje të ndryshme teksturash për të krijuar një punim me teksturë. - Shpjegon rëndësinë e dritëhijes dhe e aplikon atë në vepra të artit. - Dallon dhe aplikon vëllimin në vepra dy dhe tredimensionale. - Dallon dhe përshkruan llojet e ndryshme të hapësirës duke përdorur parimin e perspektivës e për të arritur iluzionin e hapësirës në punime artistike. - Identifikon llojet e ndryshme të baraspeshave dhe i përdor ato në vepra artistike.				- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathërsitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	
--	---	--	--	--	--	--

PLANI DYMUJOR: NËNTOR-DHJETOR

FUSHA E KURRIKULËS: ARTE

LËNDA MËSIMORE: ARTI FIGURATIV KLASA: VI

TEMA MËSIMORE: Parimet e artit

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT- KOMUNIKUES EFEKTIV

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMI KREATIV

II.1 Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESHËM

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

IV.4 Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

V.2 Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative në mjedisin e tij ose në rrethinë.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

VI.6 Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.

REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN III:

1.4 Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura.

1.5 Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre.

4.2 Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.

TEMA MËSIMORE: EKSPOZITA DHE AKTIVITETE KULTURORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT- KOMUNIKUES EFEKTIV

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESHËM

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

IV.4 Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

V.2.Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative në mjedisin e tij ose në rrethinë.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

VI.6 Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.

REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN III:

1.2 Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura.

1.3 Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre.

4.2 Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.

TEMA MËSIMORE: KRIJIMI I PUNIMEVE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT- KOMUNIKUES EFEKTIV

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMI KREATIV

II.3 Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

1.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

1.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESHËM

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

13 Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.

14 Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

V.4 Përkujdeset për shëndetin fizik dhe mendor gjatë aktivitetit fizik dhe sportiv me karakter rekreativ dhe garues, por edhe duke respektuar të tjerët gjatë garës apo lojës.

V.5. Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

VI.6 Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.

VI.8 Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.

REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN III:

1.1 Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale.

2.1 Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta.

4.2 Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxëniet për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
Parimet e artit	- Identifikon llojet e ndryshme të harmonive duke realizuar një punim me parimin e harmonisë.	Ritmi dhe harmonia	8 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Njeriu dhe natyra	Teksti shkollor
Ekspozita dhe aktivitete kulturore	- Identifikon rëndësinë dhe karakteristikat e kontrastit për të bërë dallimin midis elementeve të ndryshme figurative në një vepër arti.	Kontrasti		Diskutim	Portofoli i nxënësit	Gjuhë shqipe Edukataë figurative Edukataë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti	Softuerë arsimorë
Krijimi i punimeve	- Identifikon rëndësinë dhe karakteristikat e kontrastit për të bërë dallimin midis elementeve të ndryshme figurative në një vepër arti.	Proportionet		Lojë me role	Vlerësim i ndërsjellë	Edukata fizike, sporte dhe shëndeti	Imazhe ilustruese
	- Përdor lloje të ndryshme të kontrastit në punime artistike.	Ekspozita e jonë		Brainstorming		Shoqëria dhe mjedisi	CD
	- Shpjegon dhe përshkruan rolin dhe rëndësinë e proporcioneve për realizimin e saktë të raportit në mes të formave të ndryshme.	Teknika e vizatimit		Diagrami i Venit		Gjuhë angleze	
		Peizazh me teknikën e vizatimit		Punë në grupe		Matematikë	
		Teknika e akuarelit		Punë individuale		Çështjet ndërkurrikulare	
		Peizazh me teknikën e akuarelit				- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike	
						- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
						- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë	
						- Globalizimi dhe ndërvlerësia	
						- Edukimi për media	

PLANI TREMUJOR: JANAR, SHKURT, MARS
FUSHA E KURRIKULËS: ARTE
LËNDA MËSIMORE: EDUKATË MUZIKORE KLASA: VI

TEMA MËSIMORE: Krijimi i punimeve

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT- KOMUNIKUES EFEKTIV

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMI KREATIV

II.3 Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

II.5. Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESHËM

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

13 Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.

14 Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

14 Përkujdeset për shëndetin fizik dhe mendor gjatë aktivitetit fizik dhe sportiv me karakter rekreativ dhe garues, por edhe duke respektuar të tjerët gjatë garës apo lojës.

15 Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

VI.6 Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.

VI.8 Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.

REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN III:

1.1 Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale.

Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara.

2.1 Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta.

4.2 Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.

TEMA MËSIMORE: Periudha historike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT- KOMUNIKUES EFEKTIV

I.1 Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkruues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMI KREATIV

II.7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESHËM

III.1 Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

III.7 I parashtrohet pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

IV.3 Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

VI.1 Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.

REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN III:

1.1 Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artiste të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.

1.2 Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

4.1.Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
Krijimi i Punimeve	- Realizon piktura aplikative në teknikën e mozaikut dhe kolazhit.	Teknika e mozaikut	11 orë	Bisedë	Buletini i pjesëmarrjes	Njeriu dhe natyra	Teksti shkollor
Periudha Historike	- Krijon duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (ngjyrë, vlerën, intensitetin etj.).	Teknika grafike e shtrypit: monotipi		Diskutim	Portofoli i nxënësit	Gjuhë shqipe	Softuerë arsimorë
	- Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	Teknika fotografike dhe përdorimi i aparatit		Lojë me role	Vlerësim i ndërsjellë	Edukata muzikore	Imazhe ilustruese
	- Identifikon shembuj për përbërjen dhe strukturën e formave (tredimensionale).	Imazhet fotografike dokumentojnë historitë		Brainstorming		Edukata fizike, sporte dhe shëndeti	CD
	- Realizon punime në teknikat e grafikës duke mësuar veçoritë dalluese të saj.	Ftesa e ditëlindjes		Diagrami i Venit		Shoqëria dhe mjedisi	
	- Realizon fotografi artistike duke përdorur mjetet dhe teknikat manuale apo digitale.	Modelimi i Relievit		Punë në grupe		Gjuhë angleze	Çështjet ndërkurrikulare
	- Manipulon me imazhe fotografike duke përdorur programe të ndryshme kompjuterike.	Modelimi i vazos		Punë individuale		Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike	

- Realizon punime të ndryshme në dizajn të produkteve të ndryshme. - Modelon vepra skulpturale në reliev dhe skulpturë tredimensionale duke përdorur forma të ndryshme. - Përzgjedh dhe përdor materiale dhe teknika të ndryshme për të krijuar skulptura të ndryshme. - Përdor materiale të ndryshme për të krijuar konstruksione të ndryshme arkitektonike në miniaturë. - Njeh vepra arti nga vende, kultura	Konstruksioni në arkitekturë Arti në parahistori Arti në Mesopotami Arti egjiptian	- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathhtësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media
---	--	---

PLANI TREMUJOR: PRILL, MAJ, QERSHOR
FUSHA E KURRIKULËS: ARTE
LËNDA MËSIMORE: EDUKATË MUZIKORE KLASA: VI
TEMA MËSIMORE: Periudha historike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT- KOMUNIKUES EFEKTIV

I.1 Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMI KREATIV

II.7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESHËM

III.1 Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

III.7 I parashtrohet pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

IV.3 Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

1.6 Përkujdeset për shëndetin fizik dhe mendor gjatë aktivitetit fizik dhe sportiv me karakter rekreativ dhe garues, por edhe duke respektuar të tjerët gjatë garës apo lojës.

1.7 Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porositë apo kërkesën e tyre vizuale.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

VI.1 Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.

REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN III:

1.1 Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.

1.2 Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.).

4.1.Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse.

TEMA MËSIMORE: Vizita dhe ngjarje artistike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT- KOMUNIKUES EFEKTIV

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMI KREATIV

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESHËM

III.8 Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

IV.3 Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

V.5 Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

VI.8 Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.

REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN III:

3.3 Njohin ngjarje, institucione, e zhvillime artistike të rëndësishme të periudhave të ndryshme historike në kontekste të ndryshme shoqërore (lokal, regional, kombëtar, global etj.).

4.3 Çmojnë veprat e trashëgimisë kulturore-popullore në ambientin ku jetojnë.

TEMA MËSIMORE: Vlerësimi i veprave artistike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT- KOMUNIKUES EFEKTIV

I.1 Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMI KREATIV

II.7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESHËM

III.1 Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

III.7 I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

IV.3 Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

V.5 Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

VI.1 Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.

REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN III:

3.2 Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

4.1 Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse.

TEMA MËSIMORE: Ekspozita dhe aktivitete kulturore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I-KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT- KOMUNIKUES EFEKTIV

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II. KOMPETENCA E TË MENDUARIT- MENDIMI KREATIV

II.6 Interpretin rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III. KOMPETENCA E TË NXËNIT – NXËNËS I SUKSESHËM

III.1 Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

III.7 I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

IV. KOMPETENCA PËR JETË, PËR PUNË DHE PËR MJEDIS – KONTRIBUES PRODUKTIV

IV.3 Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.

V. KOMPETENCA PERSONALE – INDIVID I SHËNDOSHË

14 Përkujdeset për shëndetin fizik dhe mendor gjatë aktivitetit fizik dhe sportiv me karakter rekreativ dhe garues, por edhe duke respektuar të tjerët gjatë garës apo lojës.

15 Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.

VI. KOMPETENCA QYTETARE – QYTETAR I PËRGJEGJSHËM

VI.6 Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.

VI.8 Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.

REZULTATE E TË NXËNIT TË FUSHËS PËR SHKALLËN III:

3.3 Njohin ngjarje, institucione, e zhvillime artistike të rëndësishme të periudhave të ndryshme historike në kontekste të ndryshme shoqërore (lokal, regjional, kombëtar, global etj.).

1.1 Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse.

1.2 Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjete dhe materialet
Periudha historike Vizita dhe ngjarje artistike Vlerësimi i veprave artistike Ekspozita dhe aktivitetet kulturore	- Njeh vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore. - Informohet rreth zhvillimeve bazë të historisë së artit duke dalluar disa nga këto periudha. - Njeh disa nga përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike. - Identifikon dhe njeh disa nga veprat më të njohura të artit. - Viziton institucione të ndryshme të artit si muze, galeri, qendra kulturore, vizita virtuale në internet në faqe të ndryshme etj.; Viziton atelie dhe studio të artistëve, dhe ndanë eksperiencat me artistët profesionist.	Arti egjiptian Arti grek Arti romak Qytetet antike në Kosovë dhe Shqipëri Arti islam Arkeologjia, restaurimi dhe muzeu Krahasonjme teatrit grek me amfiteatrin romak Ekspozita e fundvitit	9 orë	Bisedë Diskutim Lojë me role Brainstorming Diagrami i Venit Punë në grupe Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësimi i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukata figurative Edukata muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë Çështjet ndërkurrikulare - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathhtësi për jetë - Globalizimi dhe ndërvlerësia - Edukimi për media	Teksti shkollor Softuerë arsimorë Imazhe ilustruese CD

	- Analizon punimet, debaton për trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit. - Analizon dhe vlerësojë krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike. - Merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë, Galeri e komunitet. - Vëren, përjeton, analizon, çmon, vlerëson e gjykon punën artistike në mënyrë analitike-kritike përmes punimeve individuale, grupe brenda dhe jashtë klasës, ekspozitave të organizuara shkollore.	
--	--	--

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 1

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Elementet figurative		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Njeh, përshkruan dhe përdor elementet dhe parimet e gjuhës figurative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. II.4. Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse. III.3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.4. Komunikojnë me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale), në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.)			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Perceptimi pamor			
Fjalët kyçe: perceptim pamor, pesë shqisat, iris, bebëz, retinë, iluzion optik.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - vëzhgon me vëmendje mjedisin që e rrethon; - reflekton për mënyrën sesi funksionon perceptimi pamor; - zbulon që drita është faktor i rëndësishëm për perceptimin; - zbulon që iluzioni optik ndodh kur truri ynë nuk e kupton imazhin.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë perceptimin pamor dhe iluzionet optike.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore dhe bashkëbisedim Mësuesi/ja orienton vëzhgimin e nxënësve ndaj materialeve fotografike ku paraqiten fëmijë që përdorin shqisat për të perceptuar objekte të ndryshme. Nxënësit nxiten të flasin për njohuritë që kanë mbi shqisat dhe se si ato i ndihmojnë për të perceptuar objektet e ndryshme nëpërmjet të parit, prekjes, dëgjimit, shijimit dhe nuhatjes. Nëpërmjet shfaqjes së imazhit të syrit, nxënësit përqendrohen te shqisa e të parit. Ata/ato tashmë e dinë se nëpërmjet syrit realizohet perceptimi pamor.			

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, bisedë, hulumtimi i orientuar

Mësuesi/ja shpjegon që syri është organi kryesor nëpërmjet të cilit njeriu percepton botën që e rrethon dhe se faktori i dritës e bën të mundur këtë. Për ta kuptuar sa më mirë, këtë ata/ato duhet të mësojnë se si funksionon syri i njeriut. Mësuesi/ja nëpërmjet ilustrimeve shpjegon edhe mënyrën e funksionimit të syrit të njeriut. Këto ilustrime tregojnë që drita ndriçon objektet, ndërsa lënda kristalin e syrit tonë kur bie në kontakt me dritën, fokuson imazhin. Imazhi përcillet në retinë dhe nëpërmjet nervit optik përcillet në tru, i cili e kthen drejt imazhin e kthyer përmbys nga retina. Aparati fotografik funksionon si syri ynë. Nëpërmjet këtij informacioni, nxënësit/et duhet të kuptojnë që shqisa e të parit është kryesore për të zhvilluar aftësitë komunikuese në artin pamor. Iluzionet optike janë të rëndësishme për të kuptuar se si orientohet vëmendja jonë pamore. Mësuesi/ja shfaq imazhe të cilat truri ynë e ka të vështirë t'i përcaktojë dhe u drejton nxënësve pyetje të tilla: Çfarë shikoni në këto imazhe? Po shikoni dy figura? A janë të barabarta objektet? Sa figura shihni këtu? Përse nuk jemi të qartë në atë që shohim? Nëpërmjet këtyre pyetjeve, mësuesi/ja i nxit nxënësit të flasin rreth imazheve që shohin. Mësuesi/ja shpjegon se këto imazhe që truri ynë nuk i përcakton saktë quhen iluzione optike, duke sqaruar gjithashtu edhe arsyen pse truri ynë gabon në këto raste.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Kujtesa pamore dhe diskutimi

Nxënësit/et ftohen të diskutojnë me njëri-tjetrin për fotografitë me iluzione optike dhe diskutojnë rëndësinë e të gjitha shqisave, e në veçanti atë të të parit, në perceptimin pamor.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra vendoset nga mësuesi/ja.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 2

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Elementet figurative		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Njeh, përshkruan dhe përdor elementet dhe parimet e gjuhës figurative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. II.4. Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse. III.3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.4. Komunikojnë me mjetet shprehëse artistike përkatëse (Muzikë, Dramë, vallëzim dhe Arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shenja dhe pika			
Fjalët kyçe: shenjë grafike, shenjë piktorike, shenjë arkitektonike, shenja plastike, pikë.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - vëzhgon me vëmendje mjedisin që e rrethon dhe percepton shenjat dhe pikat; - reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon; - zbulon karakteristikat shprehëse të shenjës dhe pikës; - krijon duke përdorur në mënyrë të qëllimshme karakteristikat e pikës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë karakteristikat e shenjave dhe pikës; materiale si: lapsa, flamastera me trashësi të ndryshme, plastelinë, akuarele ose temperë, letra vizatimi, shkop.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore dhe bashkëbisedim

Mësuesi/ja orienton vëzhgimin drejt materialeve fotografike ku paraqiten detaje nga një pikturë, nga një grafikë ose një vizatim, nga një skulpturë dhe nga një sipërfaqe arkitekture. Nxënësit/et nxiten të flasin se çfarë paraqesin këto detaje fotografish. Mësuesi/ja pyet: A është kjo një pjesë e marrë nga një pikturë? Si e kuptojmë këtë? A është kjo një pjesë e marrë nga një vizatim? Si e kuptojmë këtë? Po këto fotot e tjera pjesë e kujt janë? A janë këto pjesë të arkitekturës dhe të skulpturës? Pikërisht këto janë shenja dalluese të teknikave të ndryshme që realizohen nëpërmjet mjeteve të ndryshme specifike. Në këtë mënyrë kuptohen shenjat specifike të vizatimit që quhen shenja grafike, shenjat e pikturës quhen piktorike, shenjat e skulpturës dhe të arkitekturës quhen përkatësisht: shenja plastike dhe arkitektonike.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, harta e të pyeturit, demonstrimi

Mësuesi/ja shpjegon që këto shenja do të kuptohen më mirë gjatë studimit të teknikave artistike. Mësuesi/ja nëpërmjet imazheve që ilustron pikën, nxit nxënësit/et për të diskutuar nëpërmjet pyetjeve: Çfarë shohim në foto? Si janë krijuar konturet e ndërtesës në foton e parë? Po në foton e dytë, si janë organizuar ato? A krijojnë këto pika format e objekteve që ndodhen aty? (Pra, të gjitha objektet që shohim në foto janë të krijuara nga pika të vogla drite. Ne mund ta përdorim pikën në mënyra të ndryshme për të krijuar figuracione të larmishme). Mësuesi/ja shpjegon që pika është një element shumë i vogël që gjendet në natyrë dhe ilustron nëpërmjet imazheve të ndryshme. Mësuesi/ja shpjegon se pika është një element, të cilin mund ta përdorim për të krijuar dhe për të komunikuar ide. Madhësia e pikës varet nga mjeti dhe nga sipërfaqja që përdorim. Ai/a jo i fton nxënësit/et të eksperimentojnë mbi një letër, me lapsa e stilolapsa të madhësive të ndryshme. Ky eksperiment mund të përsëritet edhe mbi një sipërfaqe plastelina ku nxënësit/et kuptojnë që presioni i dorës dhe materiali ndikojnë në madhësinë e pikës. Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krijojnë duke përdorur mundësitë shprehëse të pikës. Ata/ato mund të krijojnë një kompozim në letër sipas pikturave me pika të traditës australiane ose mund të pikturojnë motive me pika mbi gurë. Mësuesi/ja demonstroi radhën e punës dhe i nxit ata/ato të krijojnë duke zgjedhur motive sipas imagjinatës së tyre. Ata/ato mund të zgjedhin ngjyra të lëngshme dhe të përdorin një shkop për realizimin e pikave.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et i vendosin detyrat e realizuara në një vend të dukshëm të klasës dhe diskutojnë. Flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Kuptojnë që pika është një element që mund ta përdorin në mënyra të ndryshme në krijimet e tyre. Mësuesi/ja u drejton pyetje të tilla si: A ndikojnë madhësia e mjeteve dhe forca që ushtrojmë në cilësinë e pikës? Po në krijimin tuaj? Materiali i përdorur a ndikon te cilësia e letrës? Cili është materiali që zgjodhët ju? Ai/a jo i orienton nxënësit/et që nëpërmjet pikës ata/ato mund të krijojnë punime të larmishme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënëses/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra vendoset nga mësuesi/ja.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 3

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Arte		Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Elementet figurative		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Dallon dhe përdor lloje të ndryshme të vijave për të realizuar punime artistike. Prezanton dhe përshkruan punimet e tij, para klasës.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. II.4. Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse. III.3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohej. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.1. Përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 2.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Vija				
Fjalët kyçe: vijë, vijë horizontale, vijë vertikale, vijë e pjerrët, vijë e ndërprerë, vijë e shkallëzuar, vijë e harkuar, vijë e valëzuar, vijë spirale.				
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon¹ me vëmendje mjedisin që e rrethon dhe percepton llojet e vijave; - reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon; - zbulon karakteristikat shprehëse të vijës; - krijon duke përdorur në mënyrë të qëllimshme karakteristikat e vijës; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të vijës në krijim.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë elementin e vijës, fletë vizatimi, laps, lapsa me ngjyra ose flamastera.				

1 Vëzhgon, reflekton dhe zbulon janë pjesë e një procesi, atij të perceptimit. Ato ndihmojnë në lidhjen e njohurive të mëparshme me ato të reja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore dhe bashkëbisedim

Mësuesi/ja shfaq një fotografi nga natyra në të cilën shënjon llojet e ndryshme të vijave që ndodhen aty. Në fotografi shihen: vija horizontale që ndan qiellin dhe tokën, vija vertikale të drurët e urës, vija e harkuar etj. Pra, në natyrë ekzistojnë disa lloje vijash.

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, punë individuale, hulumtimi i orientuar

Mësuesi/ja vazhdon të shfaqë foto nga natyra dhe foto me objekte të krijuara nga njeriu ku shfaqen vija horizontale. Mësuesi/ja fton nxënësit të identifikojnë llojet e vijave në fotografi të ndryshme nga natyra dhe me objekte të krijuara nga njeriu. Identifikohen vijat vertikale, vijat e ndërprera, vijat e shkallëzuara, vijat e harkuara, vijat spirale. Ai/a jo orienton me pyetjet: Ku i shohim tjetër këto vija? A mund të sillni shembuj të tjerë? Çfarë ndjesie krijojnë këto lloje vijash?

Mësuesi/ja shpjegon që vija është një element i artit pamor dhe nëpërmjet saj ne krijojmë konturim e objekteve. Ajo është një bashkësi pikash ashtu siç u pa te mësimi mbi pikën. Vijën mund ta krijojmë me mjete të ndryshme si: lapsi, stilolapsi, flamastera, peneli etj.

Siç e pamë nëpërmjet fotove, llojet e vijave i gjejmë në natyrë. Nëpërmjet përdorimit të vijës mund të shprehim dhe komunikojmë emocione të ndryshme.

Ushtrimi i parë në libër na tregon një mënyrë të përdorimit të vijës. Ky ushtrim është një formë eksperimenti që mund të kryhet me elementin e vijës. Nëpërmjet vijës mund të krijohen kompozime të ndryshme. Orientohen nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes mënyrën e përdorimit të vijës te peizazhi. Ata/ato nxiten të krijojnë një peizazh sipas dëshirës.

Ata përzgjedhin ngjyrat dhe mbushin me vija hapësirat e peizazhit. Është mirë që për secilin objekt ose hapësirë afër njëra-tjetrës të zgjedhin nga një ngjyrë të ndryshme (për të bërë dallimin midis tyre). Ata/ato mund të përdorin lloje të ndryshme vijash në krijimet e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Kujtesa pamore dhe diskutimi

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et nxiten të flasin për krijimet e tyre dhe të shokëve nëpërmjet pyetjeve: Çfarë tregon krijimi yt? Sa lloje vijash ke përdorur? A i ke krijuar vijat në varësi të formës së objektit? Çfarë mjetesh përdore: lapsin apo flamasterat? A është kjo një mënyrë interesante për të krijuar? A mendon se vija është një element i rëndësishëm për të krijuar? Ata/ato kuptojnë që nëpërmjet vijës mund të krijojnë kompozime të larmishme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënëses/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra vendoset nga mësuesi/ja.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 4

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Elementet figurative		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Dallon lloje të ndryshme të formave dhe realizon punimi duke përdorur elementin e formës. Krijon veprave artistike duke përdorur lloje dhe teknika të ndryshme të vizatimit. Prezanton dhe përshkruan punimet e tij, para klasës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. II.4. Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse. III.3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. 13. Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre. 14. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.1. Përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 2.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Forma dydimensionale			
Fjalët kyçe: formë dydimensionale, formë natyrale, formë gjeometrike.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - vëzhgon dhe mbledh detaje për të identifikuar format natyrale; - reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon; - zbulon se format bazë gjenden në natyrë; - përdor qëllimisht format natyrale dhe gjeometrike në mënyrë shprehëse, në krijimet e veta; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të formave natyrale dhe gjeometrike në krijim.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë elementin e formës, fletë vizatimi, laps, flamastera ose ngjyra uji.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Matematika, Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore dhe bashkëbisedim

Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten figura me kotur. Në një rëndë paraqiten forma të objekteve nga natyra dhe në tjetrën forma të ndryshme gjeometrike. Mësuesi/ja drejton pyetje të tilla: Çfarë shohim në këto imazhe? A janë këto forma të njohura për ju? A i ndajmë këto forma në natyrale dhe gjeometrike? A janë të sheshta këto forma dhe a krijohen nga një vijë e m byllur?

Ndërtimi i njohurive të reja: Kujtesa pamore, punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon se format dydimensionale i ndajmë në forma natyrale dhe në forma gjeometrike. Format gjeometrike bazë i gjejmë në natyrë. Format gjeometrike të krijuara nga dora e njeriut janë të sakta. Mësuesi/ja e ilustron mësimin me imazhe që tregojnë format gjeometrike bazë në natyrë, si edhe ato të përdorura nga njeriu për të krijuar objekte të ndryshme.

Mbasi kanë parë mënyrën se si dy artistët i kanë përdorur format gjeometrike dhe natyrale, në veprat e tyre, nxënësit/et nxiten të krijojnë. Ushtrimet në libër gjithashtu përdoren për nxitjen e punës krijuese. Ata/ato mund të zgjedhin të krijojnë:

- një kompozim si në ushtrimin e parë sipas pikturës së artistit Xhakomo Bala.
- një pikturë dekorative duke përdorur forma natyrale sipas imagjinatës së tyre e duke u mbështetur në informacionin që morën.
- një dekoracion me figura gjeometrike sipas fantazisë duke parë udhëzimet e ndërtimit të tij (Në këtë rast, mësuesi/ja duhet të shpjegojë që është e nevojshme të përdoret vizorja dhe matjet e sakta.).
- një kombinim të formave natyrale me ato gjeometrike.

Mbas udhëzimit të mësuesit/es çdo nxënës/e zgjedh mënyrën se si do të zhvillojë krijimin e tij. Gjatë procesit të punës, mësuesi/ja vazhdon të udhëzojë nxënësit/et sipas zgjedhjeve personale.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Kujtesa pamore dhe diskutimi

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ ato diskutojnë për larminë e krijimeve dhe kuptojnë që nëpërmjet përdorimit të formës dydimensionale mund të krijojnë punime të shumëllojshme. Mësuesi/ja drejton këto pyetje: Si i ke përdorur format në krijimin tënd? Përse zgjodhe format natyrale? Përse zgjodhe format gjeometrike? Si i ke kombinuar format me njëra-tjetrën? Në veprën e cilit/ës artist/e u mbështete?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra vendoset nga mësuesi/ja.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 5

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Elementet figurative		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Dallon llojet e ngjyrave dhe aplikon ato në punimet artistike. Krijon duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (ngjyrën, vlerën, intensitetin etj.). Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. II.4. Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse. III.3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. III.5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.1. Përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 2.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ngjyra			
Fjalët kyçe: ngjyrë, rrethi i ngjyrave, ngjyrë e parë, ngjyrë e dytë, ngjyrë e tretë, ngjyrë e ngrohtë, ngjyrë e ftohtë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon dhe mbledh detaje për të identifikuar ngjyrat në mjedisin që e rrethon; - reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon; - zbulon se ngjyrat krijohen nga drita; - përdor qëllimisht ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta në mënyrë shprehëse; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të ngjyrave në krijim.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë elementin e ngjyrës, fletë vizatimi, laps, ngjyra uji. (akuarele).			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore dhe kllasteri

Mësimi fillon me shfaqjen e një fotografie nga natyra dhe të pasur me ngjyra. Mësuesi/ja shkruan në dërrasë fjalën ngjyra dhe i fton nxënësit të identifikojnë ngjyrat në imazhin e shfaqur e më pas të rendisin ato koncepte që ata njohin për ngjyrën.

Ndërtimi i njohurive të reja: Harta e të pyeturit, kujtesa pamore, punë individuale

Mësuesi/ja nxjerr imazhin e spektrit të ngjyrave dhe përdor teknikën e hartës së të pyeturit për të mbajtur gjallë diskutimin e nxënësve. A është drita e bardhë? Çfarë ndodh kur drita kalon nëpërmjet prizmit? Ku e keni parë tjetër këtë fenomen? (Si në rastin e prizmit edhe të ylberit kemi të njëjtin fenomen atë të zbërthimit të dritës në spektrin e ngjyrës.) Sa ngjyra janë në spektër? A e dini ju, përse i shohim ngjyrat? Çfarë shihni në figurë? (Rrezja e dritës, e cila përmban spektrin e ngjyrave, godet objektin.) Me çfarë ngjyre shfaqet objekti në syrin tonë? A mendoni ju, se objekti, në këtë rast domatja, i përhithi të gjitha ngjyrat e tjera përveç të kuqes?

Mësuesi/ja shpjegon se drita përbëhet nga spektri i ngjyrave ose “ylberi” dhe eksperimenti me prizmin na e tregon këtë. Ngjyrat ne mund t'i shohim nëpërmjet dritës. Objektet përhithin të gjitha ngjyrat e tjera dhe shfaqin në sipërfaqe ngjyrën e tyre përkatëse. Në natyrë dhe në objektet e krijuara nga njeriu janë të pranishme ngjyra të shumëllojshme, të cilat ju tashmë i njihni. Mësuesi/ja shfaq rrethin e Itenit dhe fton nxënësit/et të identifikojnë ngjyrat e para (primare), të dyta (sekondare) dhe të treta. Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë imazhe ku shfaqen ngjyrat e ngrohta dhe ngjyrat e ftohta. Këto ngjyra na krijojnë ndjesinë e të ngrohtit pasi lidhen me fenomene që kanë lidhje me ngrohtësinë si zjarri, dielli etj. Për këtë arsye këto ngjyra i quajmë të ngrohta.

Këto ngjyra na krijojnë ndjesinë e freskisë, sepse kanë lidhje me fenomene të tilla si uji, akulli, hijet etj. Për këtë arsye i quajmë ngjyra të ftohta. Pasi prezantohen njohuritë e reja, mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krijojnë duke përdorur njohuritë e marra dhe duke u mbështetur tek ushtrimet e librit. Ata/ato mund të përdorin ngjyrat e ylberit për të krijuar një dekoracion sipas idesë së tyre ose mund të zgjedhin të përdorin kombinimin e ngjyrave të para (primare) dhe të dyta (sekondare) (ku kombinohen gjithashtu ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta), duke u mbështetur në pikturën e Henri Matis. Gjithashtu, ata/ato mund të zgjedhin të përdorin ose ngjyrat e ngrohta, ose ngjyrat e ftohta.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit i vendosin punimet të ndarë në grupe sipas zgjedhjeve që kanë bërë në krijimet e tyre. Flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë për larminë e krijimeve dhe kuptojnë që elementi i ngjyrës ofron mundësi të shumta shprehëse.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të eksperimentojnë në shtëpi me njohuritë që ata morën mbi ngjyrën.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 6

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Elementet figurative		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Përdor lloje të ndryshme teksturash për të krijuar një punim me tekturë. Krijon veprave artistike duke përdorur lloje dhe teknika të ndryshme të vizatimit. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit. II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.1. Përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 2.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike e adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Tekstura			
Fjalët kyçe: teksturë natyrale, teksturë artificiale.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon me vëmendje mjedisin që e rrethon dhe percepton llojet e teksturave; - reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon; - zbulon karakteristikat shprehëse të teksturës; - krijon duke përdorur në mënyrë të qëllimshme karakteristikat e teksturës; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të teksturës në krijim.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë elementin e teksturës, fletë vizatimi, laps, rapidograf ose lapsa me ngjyra.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Puna dhe jeta.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore dhe bisedë

Mësimi fillon me shfaqjen e një fotografie ku paraqitet një sipërfaqe që përmban ndarje me përbërje të ndryshme. Çdo ndarje përbëhet nga bashkësi erëzash me karakteristika të ndryshme. Mësuesi/ja drejton pyetje të tilla si: Çfarë shihni në figurë?

A shfaqen ndryshe këto erëza nga një kuti të tjetra? Si mendoni ju, cila është arsyeja? (Format e erëzave të ndryshme në bashkësi krijojnë sipërfaqe të ndryshme.) A ka çdo objekt një sipërfaqe me karakteristika të veçanta? (Sipërfaqen e çdo objekti e quajmë teksturë.)

Ndërtimi i njohurive të reja: Harta e të pyeturit, kujtesa pamore, punë individuale

Mësuesi/ja shfaq fotografi nga natyra të objekteve me tekstura të ndryshme dhe i fton nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes, duke u drejtuar pyetje, si: Çfarë ju bie në sy te fotografitë e lëvoreve të pemëve? A formojnë gjetet e bimëve në bashkësi një teksturë? A ka secila gjethe karakteristika të veçanta të teksturës? A shfaqen shpendët dhe kafshët me tekstura të larmishme? Cilat janë këto kafshë që shohim në foto? A mund të na thoni kafshë që kanë teksturë interesante? Mësuesi/ja shpjegon se: Të gjithë shembujt për teksturën që pamë janë nga natyra dhe këtë lloj tekture do ta quajmë teksturë natyrale. Po në jetën e përditshme ku e shohim teksturën? Mësuesi/ja shfaq objekte të ndryshme me teksturë interesante të krijuara nga njeriu dhe pyet: A janë këto objekte të krijuara nga dora e njeriut? Me çfarë materialesh janë të krijuara këto objekte? A shfaqet e ndryshme tekstura e secilit objekt? A mund t'i quajmë këto tekstura artificiale? Pse?

Mësuesi/ja shpjegon se tekstura në natyrë dhe në objektet e krijuara nga njeriu paraqitet e larmishme. Ai/ ajo orienton se çdo material mund të punohet në mënyra të ndryshme për t'i dhënë karakteristika të veçanta sipërfaqes së jashtme dhe pyet: A mund ta përdorni edhe ju teksturën në krijimet tuaja? Mësuesi/ja orienton nxënësit/et për të përdorur elementin e teksturës në krijimet e tyre, duke u mbështetur në këtë shumëllojshmëri teksturash dhe në shembujt e ushtrimeve në libër.

Sipas shembullit të gjetes, nxënësit/et mund të zgjedhin të vizatojnë një formë të caktuar gjetheje ose disa prej tyre. Ata/ato mund të përcaktojnë nervin e zgjatimet, dhe çdo ndarje mund ta mbushin me tekstura të ndryshme. Mund të zgjedhin të vizatojnë një kafshë, dhe ta interpretojnë në mënyrë individuale teksturën e kafshës, duke u mbështetur në imagjinatën e tyre, por edhe në imazhe fotografike (shembujt në libër shërbejnë për të treguar mënyra të ndryshme të përdorimit të teksturës në krijim). Mësuesi/ja i orienton për mjetet që ata/ato mund të përdorin për realizimin e krijimit të tyre. Nxënësit/et duhet t'i zgjidhin vetë problemet krijuese.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit/et diskutojnë për punët e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë për larminë e krijimeve dhe kuptojnë që nëpërmjet teksturës mund të krijojnë punime interesante. Mësuesi/ja drejton pyetje të tilla si: Cila është tema që zgjodhe dhe ku u mbështete për të realizuar teksturën në krijimin tënd? Si e realizove dhe cilat materiale përdore? Nxënësit/et kuptojnë që nëpërmjet mundësive shprehëse të teksturës mund të krijojnë punime të larmishme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënëse/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të eksperimentojnë dhe të krijojnë në shtëpi me njohuritë që ata morën mbi teksturën.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 7

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Elementet figurative		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Shpjegon rëndësinë e dritë hijes dhe aplikon atë në vepra të artit. Dallon dhe aplikon vëllimin në vepra dy dhe tredimensionale. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. VI.6. Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.1. Përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 2.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre. 4.2.Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vëllimi			
Fjalët kyçe: vëllim, dritë, hije e objektit, hije e mbartur.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon dhe mbledh detaje për të identifikuar vëllimin; - reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon; - zbulon se drita u jep vëllim objekteve; - përdor dritën dhe hijen për të krijuar vëllimin e objekteve; - vlerëson punën e tij dhe të shokëve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë elementin vëllimin dhe burimin e dritës, fletë vizatimi, laps, flamastera, ngjitës.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore dhe bisedë

Mësimi fillon me shfaqjen e një fotografie ku burimi i dritës duket qartë nëpërmjet objektit të paraqitur aty (Mësuesi/ja i referohet imazhit në libër ose zgjedh vetë një imazh). Mësuesi/ja drejton pyetje të tilla si: Nga cila anë është burimi i dritës? A e shohim qartë ngjyrën dhe formën e frutave në foto? Po në pjesën e hijes a e kuptojmë formën e frutave? Po në zonën ku drita nuk hyn fare a mund të shohim? (Në këtë mënyrë, nxënësit kuptojnë që drita bën të mundur që ne të shohim formën e objekteve, ngjyrën dhe vëllimin e tyre.).

Ndërtimi i njohurive të reja: Harta e të pyeturit, kujtesa pamore, punë individuale

Mësuesi/ja orienton nxënësit të shohin dy imazhe ku shfaqet i njëjti objekt. Në njërin nga fotografitë drita është e fortë dhe krijon kontrast, ndërsa në tjetrën objekti shfaqet në një ditë gri kur drita nuk krijon kontraste. Ku qëndron ndryshimi midis këtyre fotografive? Si janë ngjyrat në fotografinë e parë? Në cilën anë bie drita dhe në cilën anë të ndërtesës bie hija? Po në fotografinë e dytë, a kemi anë të ndriçuar të ndërtesës dhe anë në hije të saj? Në çfarë momenti dhe kohe është bërë kjo fotografi?

Mësuesi/ja orienton të vëzhgojnë imazhe me natyra të qeta ku kontrasti i dritëhijes është shumë i fortë dhe shpjegon që drita bën të mundur që ne të kuptojmë vëllimin e objekteve nëpërmjet dritëhijes që krijohet. Ai/ajo tregon që hija, e cila ndodhet brenda objektit në zonën e pandriçuar, quhet hija e objektit dhe hija që objekti lëshon në tokë, quhet hija e mbartur.

Mësuesi/ja i nxit nxënësit që në krijimin e tyre të pasqyrojnë objekte ku vëllimi i tyre krijohet nga drita dhe hija. Shembujt e ushtrimeve në libër përdoren për të nxitur nxënësit/et në krijim. Udhëzimi dhe demonstrimi i mësuesit është i rëndësishëm për të realizuar detyrën. Nxënësit/et mund të vizatojnë një objekt çfarëdo, direkt nga natyra ose nga imagjinata, apo edhe një objekt nga revistat. Në fillim duhet të përcaktojnë burimin e dritës. Nëse përcaktojnë burimin e dritës me një pikë (ashtu si te shembujt në libër) heqin një vijë drejt kontureve të objektit për të përcaktuar hijen e objektit. Brenda objektit përcaktojnë hijen e tij dhe dritën.

Kompozimin e krijuar mund ta punojnë bardhë e zi me laps ose edhe me ngjyra.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et diskutojnë për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Diskutojnë për mënyrën se si e krijuan vëllimin e objektit nëpërmjet dritëhijes. Shpjegojnë nëse kanë arritur të tregojnë qartë hijen e objektit, hijen e mbartur në marrëdhënie me burimin e dritës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të eksperimentojnë dhe të krijojnë në shtëpi me njohuritë që ata morën mbi vëllimin dhe burimin e dritës.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 8

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Elementet figurative		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Dallon dhe përshkruan llojet e ndryshme të hapësirës duke përdorur parimin e perspektivës për të arritur iluzionin e hapësirës në punime artistike. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. VI.6. Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.1. Përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 2.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Hapësira			
Fjalët kyçe: hapësirë, hapësirë e brendshme, hapësirë e jashtme, treguesit hapësinorë, mbivendosje, objektet afër dhe objektet larg.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon me qëllim për të identifikuar llojet e ndryshme të hapësirës; - reflekton mbi mënyrën sesi e perceptojmë në hapësirën; - zbulon karakteristikat dalluese të llojeve të hapësirës dhe disa nga mënyrat e paraqitjes së saj në sipërfaqen dydimensionale; - përdor qëllimisht mënyrën e paraqitjes së hapësirës për të arritur rezultatin e dëshiruar; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e paraqitjes së hapësirës në krijim.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë njohuritë mbi hapësirën, fletë vizatimi, laps, rapidograf, flamastera ose akuarele.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore dhe bisedë

Mësimi fillon me pyetjet që mësuesi/ja u drejton nxënësve: Çfarë kuptoni ju me hapësirë? A zhvillohet jeta dhe veprimtaria jonë në hapësirë? Çfarë karakteristikash kanë objektet në hapësirë? A kanë objektet gjatësi, gjerësi dhe thellësi? A mund t'i shohim ne objektet në hapësirë nga të gjitha anët? Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë imazh fotografik nga një ambient i brendshëm dhome dhe pyet: Çfarë shohim këtu? A mund ta quajmë këtë një hapësirë të brendshme dhe të mbyllur?

Mësuesi/ja shfaq tri foto, në njërin një hapësirë urbane qyteti, në të dytën një hapësirë brenda në pyll dhe në të tretën një hapësirë të hapur ku syri shkon shumë larg dhe pyet: A është kjo një hapësirë brenda në qytet? A mund të shkojë vështrimi ynë përtej ndërtesave? Po në fotografinë e pyllit, a mund të shikojë syri shumë larg? Po në foton e tretë a ka kufi shikimi ynë?

Ndërtimi i njohurive të reja: Harta e të pyeturit, kujtesa pamore, punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon se në dy fotografitë e para kemi dy hapësira të mesme dhe në të fundit kemi një hapësirë të hapur. Po në art, si e shprehim hapësirën me tri përmasa?

Mësuesi/ja orienton vëzhgimin ndaj imazhit të një skulpture të rrumbullakët dhe të një pikturë dhe pyet: A është skulptura me tri përmasa? A mund ta shohim atë nga të gjitha anët? Po piktura sa përmasa ka? (Ndryshe nga skulptura piktura ka dy përmasa.)

Mësuesi/ja shpjegon se si paraqitet hapësira në një sipërfaqe me dy përmasa siç është vizatimi dhe piktura. Për këtë orienton vëzhgimin në imazhe ku objektet ose hapësirat njëra pas tjetrës vijnë duke u zvogëluar, objekte afër dhe larg, objekte të mbivendosura, dhe drejton pyetje për të mbajtur gjallë diskutimin dhe kuriozitetin e nxënësve. Mësuesi/ja shpjegon se këto janë disa mënyra për të shprehur hapësirën mbi një sipërfaqe dydimensionale.

Nëpërmjet ushtrimeve të librit ku jepen dy mënyra të paraqitjes së hapësirës, mësuesi/ja i nxit e i orienton nxënësit/et të krijojnë, duke përzgjedhur një nga këto dy mënyra. Ata/ato mund të krijojnë një peizazh, duke përdorur njërën nga këta tregues, sipas imagjinatës së tyre ose duke u mbështetur në shembujt e ndryshëm fotografikë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Diskutojnë për mënyrën që kanë zgjedhur për të paraqitur hapësirën dhe se si e kanë realizuar atë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të eksperimentojnë dhe të krijojnë në shtëpi mënyrat e paraqitjes së hapësirës në krijim.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 9

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Parimet e artit		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Dallon rregullat e kompozimit dhe i përdor ato për të kompozuar vepra artistike. Identifikon dhe aplikon llojet e ndryshme të kompozicionit në punimet e tyre artistike. Identifikon llojet e ndryshme të baraspeshave dhe përdor ato në vepra artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.1. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme. III.5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. V.2. Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative në mjedisin e tij ose në rrethinë. VI.6. Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura. 1.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kompozimi dhe parimet e tij. Baraspesha			
Fjalët kyçe: parimet e artit, baraspesha, simetri, simetri rrethore, asimetri.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon me qëllim për të identifikuar simetrinë dhe asimetrinë në mjedisin rrethues; - reflekton mbi mënyrën se si e perceptojmë në baraspeshën në mjedisin që na rrethon; - zbulon karakteristikat e simetrisë dhe asimetrisë për të arritur baraspeshë; - përdor qëllimisht simetrinë dhe asimetrinë në krijim; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të simetrisë dhe asimetrisë në krijim.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë prezantimin paraprak të parimeve të kompozimit dhe njohuritë mbi baraspeshën, fletë vizatimi, imazhe nga revistat dhe fleta me ngjyra, laps, gërsërë, flamastera ose akuarele.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Matematika, Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kujtesa pamore dhe bisedë

Në fillim të orës, mësuesi/ja bën një prezantim të parimeve të artit. Nëpërmjet një imazhi, në rastin e librit është përdorur një ndërtesë qytetare tradicionale me vlera artistike, mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë dhe të dallojnë parimet e artit që ndërtojnë qoftë ndërtesën në vetvete, ashtu edhe imazhin fotografik.

Prezantimi është thjesht informative. Nxënësit do të njihen në mënyrë të veçantë me secilin parim. Baraspesha është pikërisht parimi i parë me të cilin nxënësit do të njihen këtë orë mësimi. Imazhi i fluturës është një fillim i mirë për të kuptuar këtë parim. Pyetjet që drejton mësuesi/ja janë: A është fluturë e barabartë në të dyja anët e saj? A quhet fluturë simetrike? A ndahen objektet simetrike në dy pjesë të barabarta duke iu referuar qendrës së tyre që ndryshe quhet aksi i simetrisë?

Ndërtimi i njohurive të reja: Harta e të pyeturit, kujtesa pamore, punë individuale

Mësuesi/ja orienton vëzhgimin ndaj imazheve simetrike nga natyra dhe objekte të krijuara nga njeriu duke drejtuar pyetje për diskutim nxënësve. Më pas, vëzhgimi fokusohet në imazhe ku shfaqet simetria rrethore dhe nxënësit diskutojnë duke lidhur edhe njohuritë e tyre në matematikë. Më pas, vëzhgimi fokusohet tek imazhet me objektet nga natyra dhe të krijuara nga njeriu që janë asimetrike. Nxënësit nxiten të japin shembuj të asimetrisë nga natyra dhe nga objektet e krijuara nga njeriu.

Mësuesi/ja shpjegon që me simetri kuptojmë një objekt ose një krijim ku të dyja anët e saj janë të barabarta dhe të baraslarguara nga aksi i simetrisë. Simetri rrethore kemi atëherë kur të gjitha anët e objektit janë të baraslarguara nga qendra. Asimetri kemi atëherë kur objektet nuk shfaqen të njëjta në të dyja anët e tyre, por janë të baraspeshuara (si në një peshore).

Mësuesi/ja i nxit nxënësit të krijojnë, duke përdorur simetrinë ose simetrinë rrethore, si dhe shpjegon që edhe pasqyrimi në ujë është një formë e simetrisë. Duke u mbështetur në ushtrimet e librit, ata/ato mund të zgjedhin të krijojnë një kompozim me pasqyrimin e ujit. Në fillim mund të krijojnë gjysmën e kompozimit nëpërmjet imazheve të gatshme të marra nga revistat dhe më pas mund ta riprodhojnë atë në pjesën e poshtme në formën e një pasqyrimi. Gjithashtu, nxënësit mund të krijojnë rozeta dekorative me letra sipas udhëzimeve në libër. Rozeta është një ilustrim shumë i mirë i simetrisë rrethore dhe kombinimet për ta krijuar me letër janë të pafundme. Gjatë kohës që nxënësit krijojnë, mësuesi/ja i nxit dhe i udhëzon.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit të saj dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë se cilën nga llojet e baraspeshës simetrike përdorën në punët e tyre. Ata/ato kuptojnë se përdorimi i simetrisë është mënyra më e thjeshtë për të arritur baraspeshën në krijim.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të eksperimentojnë dhe të krijojnë në shtëpi duke përdorur njohuritë që morën mbi baraspeshën.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 10

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Parimet e artit		Rezultati i të nxënës të temës (nga plani dymujor): Dallon rregullat e kompozimit dhe i përdor ato për të kompozuar vepra artistike. Identifikon llojet e ndryshme të harmonive duke realizuar një punim me parimin e harmonisë. Analizon ritmin në punime të ndryshme artistike dhe aplikon lloje të ndryshme të ritmit në punët e tyre.	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.1. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme. III.5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. V.2. Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative në mjedisin e tij ose në rrethinë. VI.6. Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmer, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura. 1.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ritmi dhe harmonia			
Fjalët kyçe: ritmi, harmonia, motive, dekoracioni.			
Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore: - vëzhgon me qëllim; - për të identifikuar ritmin në mjedisin rrethues; - reflekton mbi mënyrën se si ndërthuret ritmi në punime të ndryshme artistike; - zbulon që përsëritja e elementeve në mënyrë ritmike krijon harmoninë; - përdor qëllimisht ritmin për të arritur harmoninë në krijim; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të ritmit për të krijuar harmoninë në krijim.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë njohuritë mbi ritmin dhe harmoninë, fletë vizatimi, karton, gërshtë, laps, ngjyra uji.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Matematika, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Artet (muzika), Shkencat e natyrës.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: brainstorming dhe bisedë

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën ritëm dhe i nxit nxënësit të shprehin mendimin e tyre rreth kësaj fjale. Mësuesi/ja shënon në tabelë çdo fjalë apo çdo mendim që lidhet me ritmin. Ato mund të jenë: muzika, muzika ritmike, përsëritja, vrapi, eja sportive, noti, rrahjet e zemrës etj., mësuesi/ja i nxit nxënësit të shpjegojnë edhe lidhjen e këtyre fjalëve me ritmin.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, punë individuale

Mbas bisedës mbi shembujt e ndryshëm të ritmit në natyrë dhe në jetën e përditshme, mësuesi/ja shpjegon se përsëritja e rregullt e dy fenomeneve, dy tingujve, lëvizjeve etj., krijojnë ritmin. Ritmi ka një zhvillim të rregullt si kur është i thjeshtë, ashtu edhe kur është i ndërlikuar.

Nëpërmjet imazheve nga arti dekorativ në periudha të ndryshme historike, mësuesi/ja shpjegon mënyrën e përdorimit të ritmit.

Mësuesi/ja shpjegon që Harmonia në një vepër art krijohet kur të gjitha elementet e artit (vija, forma, ngjyra, tekstura lidhen dhe plotësojnë njëra-tjetrën). Përsëritja e tyre në një ritëm të caktuar është një mënyrë e mirë për të arritur harmoninë në një vepër arti.

Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krijojnë një dekoracion, duke përdorur një motiv të thjeshtë popullor. Pasi kanë zgjedhur dhe realizuar motivin, ata nxiten të kombinojnë ritmin e përhapjes së motivit për të krijuar një dekoracion harmonik. Nxënësit mund të eksperimentojnë duke krijuar lloje të ndryshme ritmi. Ata porositen që të harmonizojnë edhe ngjyrat nëpërmjet përsëritjes.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit të saj dhe vështirësitë që hasën. Ata/ ato diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të ritmit në krijimet e tyre. Ata/ato kuptojnë se nëpërmjet përsëritjes së elementeve mund të krijohen punime të ndryshme ritmike dhe se nëpërmjet kësaj përsëritjeje krijohet harmonia.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënëses/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të eksperimentojnë dhe të krijojnë në shtëpi punime nëpërmjet ndërthurjeve të ndryshme të ritmit.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 11

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Parimet e artit		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Identifikon rëndësinë dhe karakteristikat e kontrastit për të bërë dallimin midis elementeve të ndryshme figurative në një vepër arti. Përdor lloje të ndryshme të kontrastit në punime artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve. III.5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. V.2. Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative në mjedisin e tij ose në rrethinë. VI.6. Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2.Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura. 1.3.Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kontrasti			
Fjalët kyçe: kontrasti, kontrasti i formave, kontrasti i ngjyrave, kontrasti bardhë e zi.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - vëzhgon me qëllim për të identifikuar kontrastin në mjedisin rrethues; - reflekton mbi mënyrën se si shfaqet kontrasti në punime të ndryshme artistike; - zbulon që kontrasti krijohet nëpërmjet dallimit të elementeve të ndryshëm; - përdor qëllimisht kontrastin në krijim; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të kontrastit në krijim.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë njohuritë mbi kontrastin e elementeve të ndryshme, materialet sipas dëshirës.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Matematika, Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: brainstorming, kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën kontrast dhe pyet nxënësit se çfarë kuptojnë dhe ku e gjejnë kontrastin. Pasi shkruan disa mendime mbi kontrastin si p.sh. kontrasti i madh i vogël, pemë shkurre, nata dhe dita etj., mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë një imazh dhe të gjejnë dallimet në ngjyrë e në formë, pra të krahasojnë.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon që kur themi kontrast mendojmë krahasimin midis dy objekteve ose fenomeneve. Atë e gjejnë në natyrë dhe në mjedisin rrethues. Kontrasti është një nga parimet e kompozimit. Mënyra kryesore për të krijuar kontrastin është nëpërmjet përdorimit të llojeve të ndryshme të vijave, të formave, të ngjyrave, të teksturave, të përmasave etj.

Artistët e përdorin kontrastin në veprat e tyre për të dhënë një mesazh të caktuar. Nëpërmjet shembujve të ndryshëm të veprave të artit nxënësit zbulojnë përdorimin e kontrastit të bardhë e zisë, të ngjyrave dhe të formave. Mësuesi/ja i orienton nxënësit të zbulojnë kontrastin në veprën e artistit Gjelo Gjoka dhe të krijojnë edhe duke përdorur kontrastin grafik të bardhë e zisë. Ata orientohen të zgjedhin vetë teknikën me të cilën do të realizojnë punimin e tyre. Gjatë kohës që nxënësit krijojnë, mësuesi/ja i nxit dhe i udhëzon.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit të saj dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të kontrastit në punën e tyre dhe teknikën që zgjedhën. Ata/ato kuptojnë se kontrasti mund të realizohet nëpërmjet dallimit të dukshëm të elementeve të artit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të eksperimentojnë dhe të krijojnë në shtëpi duke përdorur njohuritë që morën mbi baraspeshën.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 12

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Gjuha dhe komunikimi artistik Tema: Parimet e artit		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Shpjegon dhe përshkruan rolin dhe rëndësinë e proporcioneve për realizimin e saktë të raportit në mes të formave të ndryshme. Përdor lloje të ndryshme të kontrastit në punime artistike. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve. III.5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. V.2. Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative në mjedisin e tij ose në rrethinë. VI.6. Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmer, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura. 1.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fjalët kyçe: proporcionet, proporcionet e sakta, ndryshimi i proporcioneve.			
Njësia mësimore: Proporcionet, proporcionet e sakta, ndryshimi i proporcioneve.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon me qëllim për të identifikuar proporcionet në mjedisin rrethues dhe në vepra arti; - reflekton mbi mënyrën se si shfaqen proporcionet në punime të ndryshme artistike; - zbulon që proporcioni është marrëdhënia midis dy ose më shumë objekteve; - përdor qëllimisht ndryshimin e proporcioneve në krijim; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të proporcioneve në krijim.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë njohuritë mbi proporcionet e sakta dhe ato të ndryshuara, materialet sipas dëshirës.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Matematika, Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë imazhin ku paraqiten dy topa tenisi dhe drejton pyetjen: Si paraqiten përmasat e tyre në lidhje me njëra-tjetrën? A kanë të njëjtën masë topat e tenisit që përdorim? Ata bisedojnë se në jetën reale proporcionet (përmasat) midis topave të tenisit janë të barabarta, ndërsa në imazh ato shfaqen me shkallë të ndryshme.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon se proporcioni në kompozim është marrëdhënia midis dy ose më shumë objekteve. Pro- porcionet e sakta marrin shumë rëndësi në një vepër ku imazhi shfaqet realist. Nëpërmjet imazheve të veprave të ndryshme të artit, nxënësit kuptojnë përdorimin e proporcioneve të sakta. Gjithashtu, ata kuptojnë edhe proporcionet në trupin e njeriut. Nëpërmjet imazheve të tjera, nxënësit zbulojnë përdorimin e qëllimshëm të proporcioneve të ndryshuara në një vepër. Mësuesi/ja shpjegon që proporcionet e ndryshuara përdoren për të krijuar imazhe imagjinare.

Duke u mbështetur tek ilustrimet e Lizës në botën e çudirave (një krijim i pasur në imagjinatë), mësuesi/ja i orienton nxënësit të realizojnë një krijim imagjinar ose që krijon humor nëpërmjet përdorimit të proporcioneve e ndryshuara. Ata inkurajohen të zgjedhin vetë teknikën në përshtatje me krijimin e tyre. Gjatë kohës që nxënësit krijojnë, mësuesi/ja i nxit dhe i udhëzon.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit të saj dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë mbi mënyrën e përdorimit të proporcioneve dhe teknikën që zgjedhën. Ata/ato kuptojnë se ndryshimi i qëllimshëm i proporcioneve mund të krijojë humor apo ironi.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të eksperimentojnë dhe të krijojnë në shtëpi, duke përdorur njohuritë që morën mbi baraspeshën.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 13

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Relacioni art-shoqëri Tema: Ekspozita dhe aktivitete kulturore		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë, Galeri e komunitet. Vëren, përjeton, analizon, çmon, vlerëson e gjykon punën artistike në mënyrë analitike-kritike përmes punimeve individuale, grupe brenda dhe jashtë klasës, ekspozitave të organizuara shkollore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit. II.6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim. IV.3. Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre. 14. Përkujdeset për shëndetin fizik dhe mendor gjatë aktivitetit fizik dhe sportiv me karakter rekreativ dhe garues, por edhe duke respektuar të tjerët gjatë garës apo lojës. 15. Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porositë apo kërkesën e tyre vizuale. VI. 6. Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit. VI. 8. Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.3. Njohin ngjarje, institucione, e zhvillime artistike të rëndësishme të periudhave të ndryshme historike në kontekste të ndryshme shoqërore (lokal, regional, kombëtar, global etj.). 4.1. Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ekspozita e jonë			
Fjalët kyçe: ekspozitë, përzgjedhje e punimeve, vendosje dhe ekspozim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zhvillon aftësitë krijuese dhe ndërvepruese; - komunikon në mënyrë efektive me shokët dhe shoqet e klasës; - përdor fjalorin e përshtatshëm artistik mbi gjuhën pamore, teknikat dhe historinë e artit; - diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për ndarjen e punës; - shpreh mendimin e tij/saj për rezultatet e arritura në realizimin e ekspozitës.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

krijimet e nxënësve/eve të realizuara gjatë vitit shkollor në të gjitha tematikat; mjete të tilla si: tabakë letre, ngjitës, gërshërë, pineska etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave, Bashkëjetesa dhe bashkëpunimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: bisedë

Mësuesi/ja i nxit nxënësit të diskutojnë për mënyrën se si ndërtohet një ekspozitë, duke u mbështetur në përvojat e tyre në ekspozimin e punimeve. Ai/ajo shpjegon se ata/ato do të krijojnë një ekspozitë me punimet e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: bisedë, punë grup

Mësuesi/ja i orienton nxënësit se për të hapur një ekspozitë të përbashkët duhet të punojnë në grupe. Ai/ajo e ndan klasën në katër grupe dhe orienton për ndarjen e punës. Grupi i parë së bashku me mësuesin/en do të përzgjedhë punët më të mira, në mënyrë që çdo nxënës/e të jetë pjesëmarrës/e i/e barabartë në ekspozitë. Është mirë që të ketë punime nga secila njësi mësimore.

Grupi i dytë i ndan punimet sipas tematikave dhe i kalon te grupi i tretë, i cili bën vendosjen e punëve në tabakë letre. Grupi i katërt përcakton dhe ndan hapësirat ku do të vendosen punimet dhe se si do të vendosen. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë punën, nxënësit diskutojnë për ekspozitën e tyre, për njohuritë që morën mbi gjuhën artistike dhe se si e përdorën atë në krijim. Ata/ato diskutojnë për mënyrën e bashkëpunimit dhe rezultatin e ekspozitës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra vendoset nga mësuesi/ja.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 14

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimi i punimeve: Vizatimi		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Krijon veprave artistike duke përdorur lloje dhe teknika të ndryshme të vizatimit. Prezanton dhe përshkruan punimet e tij, para klasës. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit. II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). II.5. Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë. III.3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. 2.1. Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Teknika e vizatimit			
Fjalët kyçe: vizatim, laps, gomë, letër, pluhur grafiti, argjilë, tonalitet.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së vizatimit; - përdor me kompetencë mjetet e teknikës së vizatimit; - eksperimenton me mjetet e vizatimit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së vizatimit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, ilustrime të vizatimeve të artistëve/eve të ndryshëm/me; mjete të tilla si: laps, letër, gomë.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë imazhe të vizatimeve dhe pyet nxënësit: Me çfarë teknike janë të realizuara këto krijime? A është vizatimi teknika që përdorim më shumë? A realizohen konturet dhe format e objekteve nëpërmjet vizatimit? Cili është mjeti më i zakonshëm për të realizuar një vizatim? Po mjetet ndihmëse cilat janë?
Ndërtimi i njohurive të reja: Harta e të pyeturit, eksperimenti, punë individuale Nëpërmjet teknikës së hartës së pyetjeve mësuesi/ja ndërton njohuritë e reja. Si është i formuar lapsi? Po maja e lapsit? (Maja e lapsit formohet nga pluhuri i grafitit dhe argjila.) A e keni vënë re që disa lapsa lënë shenja të ndryshme mbi letër? (Disa janë të zbehta e disa janë të forta. Kjo ndodh për arsye të përbërjes dhe të pjekjes së lapsave.) Po goma dhe letra, sa ndihmojnë në realizimin e vizatimit? (Përveç formës dhe konturit të objekteve vizatimi me laps na ofrojnë mundësi të tjera shprehëse). Mësuesi/ja shpjegon se lapsa të ndryshëm lënë shenjë të ndryshme mbi letër, disa të fortë dhe disa të lehtë dhe mund të zgjidhen sipas dëshirës. Kjo kuptohet edhe nga shenja që lapsat kanë: h, hb, b, 2b etj. Mësuesi/ja orienton nxënësit të shohin shenjat në lapsat e tyre dhe t'i provojnë mbi letër për të bërë dallimin. Mësuesi/ja vë në dukje se cilësia e lapsit mbi letër varet edhe nga presioni që dora ushtron mbi letër. Mësuesi/ja i orienton nxënësit të krijojnë shkallëzimet (gradacionet) e lapsit duke pasur parasysh shkallën e fortësisë së lapsit dhe presionin e dorës. Nxënësit duhet të zgjedhin katër lapsa me cilësi të ndryshme dhe të vizatojnë në fletën e vizatimit katër kolona të ndara në gjashtë katrorë secila. Ata/ato duhet të fillojnë punën me lapsin më të fortë. Katrorin e parë të një kolone e mbushin duke ushtruar presionin maksimal të dorës. Duke kaluar nga katrori në katror presioni i dorës vjen duke u ulur. Pasi të jenë mbushur të gjashtë katrorët e kolonës, do të shihet dallimi nga një katror te tjetri. Me lapsat e tjerë, nxënësit i mbushin katrorët duke krijuar shkallëzimet tonale të të gjithë lapsave. Gjatë punës, mësuesi/ja i udhëzon nxënësit mbi mënyrën si të përdorin presionin e dorës. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi Pasi mbarojnë punën, nxënësit shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të saj. Ata/ato shohin diferencën nga njëra kolonë te tjetra dhe nga një kuti te tjetra. Kuptojnë rëndësinë e presionit të dorës për të krijuar shkallëzimet tonale dhe llojin e lapsit të përdorur. Ata/ato kuptojnë që shkallëzimet tonale mund t'i përdorin në krijimet e tyre për të realizuar ide të ndryshme.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet: - në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore; - në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e; - në mënyrën e realizimit të detyrës; - në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të eksperimentojnë dhe të krijojnë në shtëpi duke përdorur tonalitetet e lapsit.
REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 15

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimi i punimeve: Vizatimi		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Krijon veprave artistike duke përdorur lloje dhe teknika të ndryshme të vizatimit. Prezanton dhe përshkruan punimet e tij, para klasës; Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit. II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). II.5. Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë. III.3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. 2.1. Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Peizazh me teknikën e vizatimit			
Fjalët kyçe: vizatim, peizazh, shkallëzim tonal.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së vizatimit; - përdor me kompetencë mjetet e teknikës së vizatimit; - eksperimenton me mjetet e vizatimit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së vizatimit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, ilustrime të peizazheve me teknikën e vizatimit; mjete të tilla si: laps, letër, gomë.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë peizazhe nga natyra (në këtë rast mund të përdoren edhe peizazhet të mësimi i hapësirës dhe njohuritë e marra aty). Mësuesi/ja i nxit nxënësit të flasin për njohuritë që ata/ato kanë për peizazhin dhe hapësirën nëpërmjet pyetjeve: Çfarë shohim në këto fotografi? A është karakteristikë e peizazheve hapësira? A e kuptojmë hapësirën nëpërmjet objekteve që janë aty? Çfarë ndodh me këto objekte kur largohen nga syri ynë? (Hapësirën në peizazh e kuptojmë nëpërmjet objekteve që ndodhen në planet e peizazhit.)

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, bisedë, punë individuale

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë një peizazh në teknikën e vizatimit. Ai/ajo i nxit nxënësit të vëzhgojnë me vëmendje peizazhin e artistit dhe i orienton ata/ato të shohin se si ai e ka krijuar hapësirën e peizazhit nëpërmjet shkallëzimeve tonale të lapsit. Mësuesi/ja i nxit nxënësit të krijojnë një peizazh duke përdorur shkallëzimet tonale. Ata/ato mund të mbështeten në imazhe fotografike të peizazheve (mësuesi/ja i ka lajmëruar një orë më parë për të marrë fotografi me peizazhe nga natyra ose sjell dy-tri imazhe të gjetura nga vetë ai/ajo. Është e rëndësishme që këto imazhe të kenë plane të kuptueshme për këtë grup-moshë).

Mësuesi/ja i orienton nxënësit që në fillim të bëjnë ndarjen e planeve dhe të përdorin shkallëzimet tonale duke filluar me planin e parë më të errët. Më pas, nxënësit/et vizatojnë objektet e planit të parë dhe të planeve të tjera, nëse kanë. Ata/ato punojnë si me konturet e objekteve, ashtu edhe me shkallëzimet tonale të tyre.

Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë, mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë punën, nxënësit flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë për mënyrën se si i përdorën shkallëzimet tonale dhe se si ato i ndihmuan të krijojnë hapësirën.

Nxënësit kuptojnë që teknika e vizatimit ofron mundësi të shumta shprehëse.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të krijojnë në shtëpi peizazhe me teknikën e vizatimit duke përdorur tonalitetet e lapsit, për të krijuar hapësirën.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 16

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Arte		Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimi i punimeve: Piktura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Përzgjedh dhe përdor teknika të ndryshme të pikturës për të realizuar punime artistike. Prezanton dhe përshkruan punimet e tij, para klasës. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). III.3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohej. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. V.5. Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porositë apo kërkesën e tyre vizuale. VI.6. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato, duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. 2.1. Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Teknika e akuarelit				
Fjalët kyçe: pikturë, akuarel, penel, gomë arabike, ujë, transparente, letër me rrudha.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së akuarelit; - përdor me kompetencë mjetet e teknikës së akuarelit; - krijon me teknikën e akuarelit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së akuarelit.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, ilustrime krijimesh në akuarel; mjete të tilla si: letër, akuarele, penel, gotë me ujë.				

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësimi fillon duke treguar ngjyrat e akualetit dhe një pikturë me akualet. Mësuesi/ja u drejton pyetje nxënësve: Çfarë teknike realizojmë nëpërmjet ngjyrave të akualetit? (nxënësit/et e kanë përdorur edhe më parë këtë teknikë.) Cilat janë mjetet që përdoren në këtë teknikë? Cilat janë karakteristikat e saj? A keni eksperimentuar ju me këtë teknikë? Mbi ç'sipërfaqe punojmë me teknikën e akualetit? A keni provuar të punoni në letra të ndryshme?

Ndërtimi i njohurive të reja: demonstrimi, eksperimenti, punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e akualetit, duke i demonstruar ato. Në këtë teknikë uji është shumë i rëndësishëm për të tretur ngjyrat dhe për t'i përhapur ato në letër. Penelat duhet të jenë të butë. Ngjyra e bardhë nuk e përdoret në teknikën transparente të akualetit. Puna fillohet nga tonalitetet më të lehta. Letra është e rëndësishme, ajo nuk duhet të jetë me shkëlqim, por me pore. Teknika e akualetit përdoret mbi letër të thatë dhe mbi letër të lagur. Në këtë teknikë duhet të jemi të sigurt kur e vendosim ngjyrën pasi nuk mund ta korrigjojmë më.

Mësuesi/ja orienton nxënësit të eksperimentojnë me teknikën e akualetit në letër të lagur. Në fillim laget peneli me ujë dhe më pas laget letra nëpërmjet penelit (Në këtë rast, mësuesi/ja demonstroi procesin e punës). Pasi laget letra, zgjidhet ngjyra e duhur për t'u vendosur mbi të, sipas një vizatimi ose ideje. Në këtë mënyrë vendosen ngjyrat me radhë, duke vëzhguar se si ato ndërhyjnë te njëra-tjetra. Nxënësit mund të krijojnë qiellin në momente të ndryshme (duke iu referuar ushtrimit në libër), por ata/ato mund të zgjedhin të krijojnë detin në momente të ndryshme etj. Kjo teknikë me letër të lagur është shumë e mirë për të arritur efekte të ndryshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Diskutojnë për mundësitë e shumta që ofron kjo teknikë për të krijuar. Shpjegojnë se si e kanë paraqitur qiellin ose detin në momente të ndryshme, cilat ngjyra kanë përdorur për përzgjedhjen e cilat për stuhinë dhe pse.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të eksperimentojnë me mundësitë shprehëse të teknikës së akualetit.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 17

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimi i punimeve: Piktura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Përzgjedh dhe përdor teknika të ndryshme të pikturës për të realizuar punime artistike. Krijon duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (ngjyrën, vlerën, intensitetin etj.). Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). III.3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. V.5. Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale. VI.6. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. 2.1. Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Peizazh me teknikën e akuarelit			
Fjalët kyçe: pikturë, akuarel, peizazh			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së akuarelit; - përdor me kompetencë mjetet e teknikës së akuarelit; - krijon me teknikën e akuarelit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së akuarelit.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Arti figurativ 6, ilustrime të peizazheve në teknikën e akualetit; mjete të tilla si: letër, akuarele, penel, gotë me ujë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë imazhe të peizazheve në teknikën e akualetit dhe pyet: çfarë paraqesin këto punime? A keni punuar peizazh me teknikën e akualetit? Si e keni përdorur këtë teknikë? A është e nevojshme ta skicojmë lehtë me laps peizazhin para se të fillojmë të përdorim ngjyrën? (Në mësimin e kaluar thamë që teknika e akualetit është transparente dhe se nuk e përdorim ngjyrën e bardhë.) A e fillojmë pikturën nga tonalitetet më të lehta?

Ndërtimi i njohurive të reja: demonstrimi, eksperimenti, punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon dhe demonstroi radhën e punës për të krijuar një peizazh me teknikën e akualetit. Teknika e akualetit, me të cilën u realizua detyra në mësimin e kaluar, ishte me letër të lagur. Në fillim nxënësit/et vizatojnë me kontur të lehtë hapësirat dhe objektet e peizazhit. Më pas lagin letrën me penel. Për- zgjedhin ngjyrën e dëshiruar për çdo pjesë të peizazhit dhe e përhapin me penel. Me penelin e ngopur me ujë dhe me ngjyrë krijojnë detajet: pemët, bimët, shtëpitë etj. Nxënësit/et ndjekin radhën e punës sipas demonstrimit të mësuesit/es. Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi, diagrami i venit

Diskutojnë për mundësitë e shumta që ofron kjo teknikë për të krijuar. Shpjegojnë se si e kanë krijuar peizazhin duke ndjekur hapat e duhur.

Nëpërmjet një skeme të thjeshtë të diagramit të venit, mësuesi/ja i fton nxënësit të rendisin karakteristikat e veçanta dhe të përbashkëta midis peizazhet të realizuar me teknikën e vizatimit dhe atij të realizuar me akuarela.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënëse/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të realizojnë krijime me teknikën e akualetit dhe të eksperimentojnë me mundësitë shprehëse që ajo ofron.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 18

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimi i punimeve: Mozaiku		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Realizon piktura aplikative në teknikën e mozaikut dhe kolazhit. Krijon duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (ngjyrën, vlerën, intensitetin etj.). Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). III.3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. V.5. Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porositë apo kërkesën e tyre vizuale. VI.6. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. 2.1. Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Teknika e mozaikut			
Fjalët kyçe: mozaik, copë guri ose xhami, mozaik romak, mozaik bizantin			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së mozaikut; - përdor me kompetencë mjetet e teknikës së mozaikut; - krijon me teknikën e mozaikut, duke përdorur elemente të gjuhës pamore; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së mozaikut.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe mozaikësh; mjete të tilla si: laps, letër, letra me ngjyra, gërrshërë, ngjitës (ose fara të ndryshme nëse nxënësit zgjedhin të krijojnë mozaik me fara).			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësimi fillon me shfaqjen e imazheve të mozaikëve të realizuar nga nxënës. Mësuesi/ja pyet: Çfarë teknike është kjo? A e njihni ju këtë teknikë? Çfarë materialesh keni përdorur për të realizuar punimet tuaja me këtë teknikë? A keni përdorur materiale të tjera përveç letrave me ngjyra?

Ndërtimi i njohurive të reja: demonstrimi, eksperimenti, punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon se teknika e mozaikut është një teknikë antike. Artistët/et për të ndërtuar mozaikun për- dorin gurë natyralë, gurë mermeri me ngjyra të ndryshme ose gurë xhami. Mozaiku përdoret për të dekoruar dyshemetë ose muret. Në fillim bëhet vizatimi dhe copëzat me ngjyra ngjiten sipas vizatimit. Kjo teknikë përdorej në periudhat antike në Mesopotami e në Greqi. Romakët e përdorën për të dekoruar muret dhe dyshemetë. Në periudhën e Bizantit për mozaikët u përdorën gurët e xhamit të ngjyrosur.

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të vëzhgojnë mozaikun romak me peshk dhe mënyrën se si është realizuar (Mund të zgjidhet edhe ndonjë kafshë tjetër, pasi mozaikët romakë janë të pasur me figura kafshësh). Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krijojnë një peshk, apo një kafshë tjetër dhe sipas demonstrimeve të mësuesit/es ta realizojnë në teknikën e mozaikut. Gurët mund të zëvendësohen në letra me ngjyra ose me fara me ngjyra (shembulli 2 i veprimtarisë në libër). Mbas vizatimit, nxënësit/et përzgjedhin ngjyrat e dëshiruara dhe i presin letrat në katrorë të vegjël. Këta katrorë ngjiten me ndihmën e ngjitësit duke u vendosur sipas një ritmi të caktuar. Duhet pasur parasysh që midis katrorëve të lihet hapësirë. Ndërsa nxënësit që kanë zgjedhur farat e ndryshme me ngjyra I kombinojnë ato dhe I ngjisin në vizatimin e tyre. Gjatë kohës që nxënësit punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi, diagrami i venit

Pasi mbarojnë, nxënësit flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Diskutojnë për mënyrën e realizimit të mozaikut me letër apo të atij me fara, për ngjyrat që përdorën, për temën që ata/ ato zgjedhën dhe radhën e punës që ndoqën. Ata/ato kuptojnë që nëpërmjet kësaj teknike mund të realizojnë idetë e tyre krijuese.

Nëpërmjet një skeme të thjeshtë të diagramit të venit, mësuesi/ja i fton nxënësit të rendisin karakteristikat e veçanta dhe të përbashkëta midis mozaikut të realizuar me letër dhe atij të realizuar me fara.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të realizojnë krijime me teknikën e akuarelit dhe të eksperimentojnë me mundësitë shprehëse që ajo ofron.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 19

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimi i punimeve: Grafika		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Realizon punime në teknikat e grafikës duke mësuar veçoritë dalluese të saj. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). III.3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. V.5. Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porositë apo kërkesën e tyre vizuale. VI.6. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. 2.1. Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Teknika grafike e shtypit: monotipi			
Fjalët kyçe: teknika shtypi, shtypi me relief, monotipi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës grafike të shtypit; - përdor me kompetencë mjetet e teknikës së monotipit; - krijon me teknikën e monotipit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së monotipit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe ilustruese për teknikën e shtypit dhe atë të monotipit; mjete të tilla si: letër me sipërfaqe të lëmuar ose sipërfaqe plastike, tempera ose akuarele me tubet, një rul gome ose një lugë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësimi fillon orientimin e nxënësve të vëzhgojnë imazhe të realizuara me teknikën e shtypit. Përveç imazheve, ata mund të vëzhgojnë edhe ato veshje që janë me imazhe të shtypura. Mësuesi/ja i nxit nxënësit të flasin mbi përvojat e tyre krijuese me teknikën e shtypit, duke pyetur: Cilat mjete të shtypit keni përdorur më parë? A ju ka pëlqyer kjo teknikë? Çfarë karakteristikash kanë punimet e bëra me të? A është një teknikë e shpejtë? Cilat janë materialet mbi të cilat mund të stampohet? Ju keni veshje me imazhe të shtypura dhe keni parë objekte të ndryshme të dekoruara me teknikën e shtypit. Përmendni disa prej tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: demonstrimi, eksperimenti, punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon se me teknikën e shtypit kuptojmë kalimin e një imazhi nga një sipërfaqe në një tjetër. Për ta bërë këtë, në fillim përgatitet imazhi fillestar mbi një sipërfaqe të caktuar. Ky imazh shërben si një model, të cilin e përsërisim nëpërmjet teknikës së shtypit. Këto modele mund të realizohen në sipërfaqe të sheshta, me relief (ose gdhendje) (Kuptojmë këtu se teknikën me relief nxënësit e përdorën në realizimin e detyrës në mësimin mbi ritmin dhe harmoninë).

Mësuesi/ja shpjegon se teknika e monotipit është një teknikë stampimi dhe demonstron radhën e punës së saj. Me këtë teknikë mund të përftohet vetëm një imazh. Teknikat e stampimit janë ato teknika të përfutuara prej kalimit të imazhit nga një sipërfaqe në tjetrën. E njëjta gjë ndodh edhe me teknikën e monotipit. Për të realizuar idenë nëpërmjet kësaj teknike duhet një sipërfaqe e lëmuar. Me tubetet e ngjyrave krijohet figura e dëshiruar (një natyrë e qetë me lule). Me ngjyrat, duke i përzgjedhur ato sipas dëshirës, njëkohësisht vizatohet dhe pikturohet. (Për të bërë vizatimin mund të përdoret edhe lapsi e pastaj të vendosen ngjyrat). Ngjyrat duhet të jenë pastoze. Mbi të vendoset me kujdes fleta e vizatimit dhe sipërfaqja e saj shtypet me rul ose me një lugë, që letra të ngopet me ngjyrën. Më pas, letra çohet me kujdes. Imazhi i përfutur ka krijuar efekte të rastësishme për shkak të përhapjes së ngjyrës. Për të krijuar vazën me lule, nxënësit mbështeten në imagjinatën ose në imazhe të përzgjedhura fotografike.

Gjatë kohës që ata/ato punojnë, mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë punën, nxënësit flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ ato diskutojnë për mundësitë e shumta shprehëse që ofron kjo teknikë. Ata/ato kuptojnë që nëpërmjet kësaj teknike mund të realizojnë krijime të ndryshme shumë interesante. Nxënësit diskutojnë për karakteristikat e kësaj teknike dhe të papriturat që ajo krijon.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të realizojnë krijime me teknikën e monotipit dhe të eksperimentojnë me mundësitë shprehëse që ajo ofron.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 20

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimi i punimeve: Fotografia		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Realizon fotografi artistike duke përdorur mjetet dhe teknikat manuale apo digjitale. Prezanton dhe përshkruan punimet e tij, para klasës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): 1.6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. 1.7. Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore. II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). III.3.Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. V.5. Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porositë apo kërkesën e tyre vizuale. VI.6. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. 2.1. Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Teknika fotografike dhe përdorimi i aparatit			
Fjalët kyçe: teknika fotografike, fotografi, aparat fotografik, zhvillimi i filmit, stampimi i fotografisë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të fotografisë; - përdor një aparat të thjeshtë fotografik për një qëllim të caktuar; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e shumta shprehëse të teknikës së fotografisë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, imazhe që ilustrojnë teknikën klasike të fotografisë; aparat fotografik digjital (ose celular).			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja fton nxënësit të vëzhgojnë një imazh fotografik ku paraqitet një fotograf në çastin e shkrepjes së aparatit. Mësuesi/ja u drejton pyetje nxënësve/eve për të kujtuar njohuritë e mëparshme mbi fotografinë: Çfarë shohim në këtë fotografi? A ju pëlqen fotografia? A ju pëlqen të realizoni fotografi? A keni realizuar fotografi të bukura? Çfarë ju pëlqen të fotografoni më shumë?

Ndërtimi i njohurive të reja: demonstrimi, eksperimenti, bashkëpunim në grup

Mësuesi/ja shpjegon duke orientuar vëzhgimin e imazheve që ilustrojnë filmin fotografik, zhvillimin dhe stampimin e fotografisë. Fjala “fotografi” e ka prejardhjen nga greqishtja dhe do të thotë “shkrim nëpërmjet dritës”. Parimi i fotografisë bazohet në zbulimin se disa substancave kimike janë të ndjeshme ndaj dritës. Një material, i cili përmban këto substanca, bëhet i ndjeshëm ndaj dritës dhe është në gjendje të ruajë imazhin.

Ky material është filmi fotografik. Teknika fotografike kalon nëpër tri faza: shkrepja e aparatit, zhvillimi i filmit dhe stampimi. Realizimi i kësaj teknike i përket teknologjisë së aparatit me film. Realizimi i një fotografie cilësore varet nga aftësia e fotografit për të përdorur aparatin dhe për të kapur momentin e duhur. Sot, ne përdorim aparate digjitale, të cilat janë shumë të thjeshta për t'u përdorur (edhe telefonat celularë sot realizojnë fotografi mjaft të mira, për sa i përket cilësisë).

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve përdorimin e aparatit fotografik dhe i nxit ata/ato të bëjnë fotografi. Nxënësit/et mund të dalin në ambientet e oborrit të shkollës ose brenda në klasë. Mësuesi/ja i udhëzon të kompozojnë mirë figurën ose figurat brenda kuadratit. Ata/ato realizojnë fotografi të ndryshme me njëri-tjetrin.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Në fund të orës së mësimit, mësuesi/ja i kalon fotot e aparatit në kompjuter dhe i shohin të gjithë bashkë. Nxënësit/et diskutojnë për fotografitë e realizuara, për mënyrën se si i kanë kompozuar. Nxënësit/et kuptojnë që fotografia sot luan një rol shumë të rëndësishëm në komunikimin e ideve dhe që është mënyra kryesore e komunikimit pamor në ditët e sotme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të realizojnë kompozime të ndryshme në fotografi dhe të eksperimentojnë me mundësitë shprehëse që ajo ofron.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 21

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Arte		Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimi i punimeve: Fotografia		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Realizon fotografi artistike duke përdorur mjetet dhe teknikat manuale apo digjitale. Manipulon me imazhe fotografike duke përdorur programe të ndryshme kompjuterike. Vëren, përjeton, analizon, çmon, vlerëson e gjykon punën artistike në mënyrë analitike-kritike përmes punimeve individuale, grupe brenda dhe jashtë klasës, ekspozitave të organizuara shkollë.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): 1.6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. 1.7. Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollë. II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). III.3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. V.5. Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porositë apo kërkesën e tyre vizuale. VI.6. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. 2.1. Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 2.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Imazhet fotografike dokumentojnë histori				
Fjalët kyçe: histori me fotografi, dokumentim.				
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të fotografisë; - krijon një histori ose tregim nëpërmjet imazheve fotografike; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e shumta shprehëse të teknikës së fotografisë.				

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, fotografi nga periudha të ndryshme fotografike; fotografi nga veprimtaritë dhe ngjarjet jetësore të nxënësve.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë Mësuesi/ja fton nxënësit të vëzhgojnë imazhe fotografike të kohëve të ndryshme të cilat dokumentojnë moment të ndryshme nga historia dhe pyet: Çfarë shohim në këto fotografi? Përse janë të rëndësishme imazhet fotografike? Për çfarë shërbejnë ato? A janë pjesë e historisë këto fotografi? A ndodh edhe me fotografitë tuaja e njëjta gjë kur shihni momente të kaluara të jetës suaj dhe të familjes? Po ju a keni fotografi që iu kanë bërë prindërit në momente të ndryshme të jetës? A është bukur dhe interesante kur shihni veten tuaj se si keni qenë të vegjël? A tregojnë ato fotografi pjesë nga historia e jetës dhe të familjes tuaj?
Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, punë individuale Nëpërmjet fotografisë mund të komunikohen emocione të ndryshme dhe të dokumentohen momente të rëndësishme të historisë dhe të jetës sonë. Fotografia është padyshim mënyra më e përhapur e komunikimit nëpërmjet imazhit. Edhe pse mund të mos ketë cilësi artistike, ajo ka një vlerë të madhe historike, dokumentuese dhe shkencore. Ato që një fotograf fotografon sot, nesër do të jenë pjesë e historisë, ashtu siç janë pjesë e historisë fotografi të bëra vite më parë. Mësuesi/ja i nxit nxënësit të krijojnë një histori me fotografitë që ata/ato kanë marrë. Këto janë fotografi nga momente të ndryshme të jetës së tyre (Veprimtaria në libër orienton për të ndërtuar një histori). Nxënësit përzgjedhin fotografitë sipas dëshirës, të cilat mund të tregojnë momente nga pushimet, apo nga ditëlindjet e tyre në vite etj. Ata/ato vendosin fotografitë sipas një radhe të caktuar dhe shkruajnë nga një koment poshtë çdo fotografie. Fotografitë dhe komentet së bashku krijojnë një histori. Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi/ja monitoron klasën.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et shpjegojnë historitë që ata/ato ndërtuan me fotografitë e tyre. Ata kuptojnë që imazhi fotografik është një mënyrë shumë interesante dhe mjaft e përhapur në ditët e sotme. Ata/ato diskutojnë për fotografi që tregojnë momente të veçanta dhe interesante. Nxënësit kuptojnë që nëpërmjet fotografisë mund të dokumentojnë momente të ndryshme të rëndësishme nga jeta e tyre.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet: - në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore; - në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e; - në mënyrën e realizimit të detyrës; - në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të krijojnë albume me fotografitë e tyre duke i shoqëruar edhe me të dhënat e duhura.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 22

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimi i punimeve: Dizajni grafik		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Realizon punime të ndryshme në dizajn të produkteve të ndryshme. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. IV.7. Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj). VI.6. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. 2.1. Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 4.2. Komenton krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ftesa e ditëlindjes			
Fjalët kyçe: dizajni grafik, projekt artistik, kartolina, ftesa.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të dizajnit-grafik; - përdor me kompetencë mjetet të ndryshme artistike për të realizuar idenë; - krijon duke përdorur elemente të gjuhës pamore; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë krijuese në fushën e dizajnit-grafik.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, fotografi që tregojnë dizajnin e kartolinave dhe ftesave të ndryshme; imazhe që ilustrojnë punën e dizajnit-grafik; mjetet e punës në varësi të teknikës që çdo nxënës/e do të zgjedhë për të realizuar ftesën e tij.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë materialet fotografike ku paraqiten lloje të ndryshme të kartolinave të urimit, të ftesave për ditëlindje etj. (ato mund të jenë edhe reale). Mësuesi/ja u drejton pyetje nxënësve: A keni dërguar kartolina urimi për raste festash dhe ditëlindjesh? A i zgjidhni ato në përshtatje me festën dhe me moshën e personit që ia dërgoni? Po kur organizoni ditëlindjen tuaj a u dërgoni ftesa shokëve? A ka lidhje ftesa me festën që organizoni? A i keni bërë ndonjëherë vetë ftesat e ditëlindjes për shokët? Çfarë të dhënash vendosni në ftesë?

Ndërtimi i njohurive të reja: bisedë, punë në grup

Mësuesi/ja shpjegon se, profesioni ku përfshihen veprimtari të tilla artistike si: faqosja e librave, e revistave, e gazetave, ilustrimi i librave, reklamat e produkteve, ftesat etj., quhet dizajni-grafik. Dizajnët kanë aftësi krijuese për të ndërtuar një projekt artistik dhe për ta realizuar atë. Ata/ato i realizojnë krijimet e tyre nëpërmjet programeve kompjuterike. Psh: nëse ata/ato do të realizojnë ftesa për ditëlindje, në fillim bëjnë punë përgatitore për projektin, duke mbledhur të dhëna si: cila është ose do të jetë tematika e festës?

Në çfarë moshe është fëmija që ka ditëlindjen? Çfarë do t'u pëlqente më shumë nxënësve të kësaj moshe? Ku do të zhvillohet festa?

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se ata/ato do të realizojnë një ftesë për ditëlindjen e tyre. Këtë detyrë, ata/ato mund ta realizojnë në formën e një projekti artistik duke u ndarë në grupe.

Grupet vendosin në fillim tematikën e festës që mund të jetë: piktorët e vegjël, në pishinë, emri i një personazhi të parapëlqyer etj. dhe shohin shembuj të ndryshëm të ftesave për t'u orientuar. Pasi të kenë diskutuar në grup dhe vendosur për tematikën ata/ato janë të lirë/a ta realizojnë kartolinën e tyre me teknika sipas dëshirës. Çdo nxënës/e sipas tematikës së përbashkët të grupit realizon idenë e tij/saj, duke dhënë kështu secili/a propozimin e tij/saj për ftesën.

Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë punën, secili grup prezanton projektin dhe produktin (ftesën e ditëlindjes). Ata/ato flasin për tematikën e zgjedhur e për të dhënat që kanë mbledhur dhe pastaj propozojnë kartolinën më të mirë të grupit. Nxënësit kuptojnë që dizajni-grafik është një profesion krijues dhe dizajni duhet të jetë i aftë të zgjidhë një problem në mënyrë krijuese.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të përdorin njohuritë që morën në këtë orë mësimore për të realizuar ftesat për ditëlindjet e tyre, të të afërmeve apo edhe për evente të tjera në familje apo në shkollë.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 23

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimi i punimeve: Skulptura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Modelon vepra skulpturale në relief dhe skulpturë tredimensionale duke përdorur forma të ndryshme. Përzgjedhë dhe përdor materiale dhe teknika të ndryshme për të krijuar skulptura të ndryshme. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. 2.1. Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Modelimi i relievit			
Fjalët kyçe: skulpturë, relief, skulpturë e rrumbullakët, modelim, gdhendje.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të skulpturës (relievit); - përdor me kompetencë mjetet e punës për të realizuar idenë në teknikën e relievit; - krijon duke përdorur elemente të gjuhës pamore; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë krijuese që ofron teknika e relievit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, fotografi që tregojnë skulpturën e rrumbullakët, relievin, modelimin me baltë dhe gdhendjen; mjete të tilla si: plastelinë ose das, rul, mjete të ndryshme për të krijuar relievin teksturor si shkopinj e stampa të ndryshme.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësimi fillon me orientimin e nxënësve për të vëzhguar materialet fotografike ku paraqiten skulptura të rrumbullakëta, relieve, skulptura me modelim në baltë, skulptura gjatë procesit të gdhendjes.

Mësuesi/ja i nxit nxënësit të flasin rreth skulpturës dhe përvojave të tyre në këtë teknikë. Ai/ajo u kërkon nxënësve të bëjnë dallimin midis dy fotografive ku shfaqet procesi i modelimit dhe ai i gdhendjes. Mësuesi/ja i pyet ata/ato se ku qëndron dallimi në këto dy teknika dhe i ndihmon që të përcaktojnë bashkërisht modelimin dhe gdhendjen.

Ndërtimi i njohurive të reja: bisedë, demonstrim, punë individuale

Më pas, mësuesi/ja u kërkon nxënësve të bëjnë dallimin midis dy fotografive ku shfaqen një skulpturë e rrumbullakët dhe një relief.

Mësuesi/ja shpjegon që ata/ato do të realizojnë një relief dekorativ. Mësuesi/ja i orienton nxënësit të vëzhgojnë imazhe të relievit dekorative me motive të ndryshme. Mësuesi/ja orienton nxënësit duke demonstruar mënyrën dhe radhën e punës për të krijuar relievin dekorativ (ose teksturën nëpërmjet relievit):

krijohet një sipërfaqe e sheshtë me plastelinë (mund të përgatiten disa të tilla). Me mjetet përkatëse, krijohen tekstura të larmishme mbi këto sipërfaqe duke ndjekur kombinime dhe ritme të ndryshme; këto lloj teksturash krijohen nëpërmjet gërricjes dhe shenjës që lënë këto mjete mbi plastelinën e butë; mund të krijohen pa fund pllaka dekorative, duke përdorur fantazinë. Mjetet për të krijuar mund të jenë të ndryshme. Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë për larminë e teksturave që mund të krijojnë në relief dhe i bashkojnë të gjitha relievet së bashku, për të bërë një të tërë, duke krijuar një hapësirë dekorative me relief.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të përdorin njohuritë që morën në këtë orë mësimore për të realizuar relief dekorativ, por edhe me figura të ndryshme.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 24

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimi i punimeve: Skulptura		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Modelon vepra skulpturale në reliev dhe skulpturë tredimensionale duke përdorur forma të ndryshme. Përzgjedhë dhe përdor materiale dhe teknika të ndryshme për të krijuar skulptura të ndryshme. Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. 2.1. Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Modelimi i vazos			
Fjalët kyçe: plastelinë, vazo, enë qeramike.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të modelimit me plastelinë; - përdor me kompetencë mjetet e punës për të realizuar vazon; - krijon duke përdorur elemente të gjuhës pamore; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë krijuese që ofron modelimi me plastelinë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, fotografi vazosh qeramike për funksione të ndryshme; mjete të tilla si plastelinë (argjilë) ose das, rul ose shishe, letër, gërshtë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja fton nxënësit të vëzhgojnë materiale fotografike ku paraqiten lloje të ndryshme të vazove. Vazot mund të jenë nga kultura të ndryshme dhe të kenë forma të larmishme. Mësuesi/ja i nxit nxënësit të flasin rreth vazove dhe pyet: A keni realizuar vazo më parë? Për çfarë përdoren vazot? Çfarë formash kanë ato? Me çfarë materiali realizohen?

Ndërtimi i njohurive të reja: bisedë, demonstrim, punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon se ata/ato do të realizojnë një vazo me një teknikë të caktuar. Mësuesi/ja shpjegon se modelimi i vazove është një teknikë antike e përdorur që nga koha kur njeriu filloi të ndërtonte objekte të përdorimit të përditshëm, për të përgatitur dhe ruajtur ushqimin. Përveç funksionit utilitar, ato kanë edhe funksion dekorativ. Të dyja këto funksione e kanë shoqëruar gjithmonë artin e poçerisë.

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të realizojnë një vazo të thjeshtë duke ndjekur këta hapa:

- përgatitet një model letre, baza dhe sipërfaqja anësore, në përmasat e dëshiruara dhe në varësi të materialit të plastelinës;
- plastelina përhapet mbi një sipërfaqe duke përdorur një shishe ose një rul brumi;
- plastelina pritët sipas modelit të letrës të bërë për bazën dhe për anët;
- bashkohen të gjitha pjesët, duke i ngjitur mirë me njëra-tjetrën;
- vazos mund t'i krijohet edhe një kapak duke përdorur modelin e letrës së bazës. Më pas, nxënësit zbukurojnë vazon me dekoracione të thjeshta në relief.

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënëset i vendosin vazot e tyre në një vend të dukshëm në klasë. Flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë që mund të krijojnë vazo edhe me forma të tjera gjeometrike përveç asaj cilindrike që realizuan.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të praktikojnë forma të ndryshme vazosh nëpërmjet modelimit me plastelinë.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 25

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Krijimtaria dhe performanca artistike Tema: Krijimi i punimeve: Konstruksioni		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Përdor materiale të ndryshme për të krijuar konstruksione të ndryshme arkitektonike në miniatyrë. Prezanton dhe përshkruan punimet e tij, para klasës. Analizon punimet, debaton për trajtimin çështjeve dhe problemeve të artit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. 1.2. Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. 2.1. Përdor me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 4.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Konstruksioni në arkitekturë			
Fjalët kyçe: konstruksion, strukturë, materiale të ndërtimit, shtylla, mure, dysHEME, tavane			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të konstruksionit; - përdor me kompetencë mjetet e punës për të realizuar një konstruksion; - krijon duke përdorur elemente të gjuhës pamore; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë krijuese që ofron konstruksioni.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, fotografi që tregojnë konstruksione ndërtesash me materiale të ndryshme; materiale të tilla si: karton, vizore, laps, gërrshërë, ngjitës.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja i fton nxënësit të vëzhgojnë materiale fotografike ku paraqiten lloje të ndryshme të ndërtesave, të ndërtuara me materiale të ndryshme. Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të diskutojnë mbi konstruksionet duke u drejtuar pyetje të tilla si: Me çfarë materiali është ndërtuar shtëpia? A keni parë ju shtëpi prej druri? A mund të na tregoni disa ndërtesa prej guri që keni parë? Po kalatë a janë të ndërtuara prej guri? Po Kulla Eifel me çfarë materiali është ndërtuar? A njihni ju struktura prej metali? Cilat janë materialet që përdoren për ndërtim?

Cilat janë pjesët përbërëse të ndërtesave?

Ndërtimi i njohurive të reja: bisedë, hulumtim i orientuar, punë individuale

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve që një ndërtesë ose konstruksion për të qëndruar në këmbë duhet të ketë shtylla mbajtëse, mure mbajtëse, trarë, harqe, dysheme dhe tavan. Këto janë elementet arkitektonike. Ndërtesat përbëhen edhe nga elemente përbërëse siç janë muret dhe dekorët.

Mësuesi/ja shfaq fotografi me konstruksione kullash dhe udhëzon nxënësit t'i vëzhgojnë me vëmendje mënyrën se si janë të ndërtuara këto konstruksione kullash dhe i orienton të realizojnë një kullë duke ndjekur disa hapa. Ai/ajo orienton se për ndërtimin e konstruksioneve është e rëndësishme saktësia dhe ekuilibri i pjesëve.

Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë, mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit/et i vendosin konstruksionet e tyre në një vend të dukshëm dhe diskutojnë për punën e tyre, për mënyrën e realizimit dhe për vështirësitë që hasën. Ata/ato kuptojnë që për të ndërtuar konstruksione të qëndrueshme është e rëndësishme të merren parasysh elementet arkitektonike. Me karton, ata/ato mund të ndërtojnë forma të ndryshme të konstruksioneve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra vendoset nga mësuesi/ja.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 26

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Relacioni art-shoqëri Tema: Periudha historike		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Njeh vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore. Informohet rreth zhvillimeve bazë të historisë së artit duke dalluar disa nga këto periudha. Njeh disa nga përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike. Identifikon dhe njeh disa nga veprat më të njohura të artit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. II.7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike. III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar. IV.3. Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre. VI.1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artiste të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme. 1.2. Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj. 4.1. Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Arti në parahistori			
Fjalët kyçe: parahistori, paleolit (epoka e gurit), neolit, palafite, grafit,			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon veprat e artit të periudhës para historike; - reflekton mbi mënyrën e jetesës së njerëzve duke kaluar nga shpellat në ndërtimin e kasolleve; - zbulon karakteristikat e shprehjeve arti stike dhe teknikat e përdorura në neolit dhe paleolit; - krijon duke u mbështetur në lidhjen që njerëzit e asaj periudhe kishin me natyrën; - shpreh mendimin e vet rreth veprave të artit të kësaj periudhe duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Arti figurativ 6, fotografi me imazhe ilustruese mbi periudhën e paleolitit dhe të neolitit; mjete të tilla punë si: letër, laps, lapsa me ngjyra ose flamastera.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, Kllasteri, bisedë

Mësuesi/ja shkruan në tabelë "Parahistoria", i fton nxënësit të vëzhgojnë imazhin e një pikturë në shpellë dhe i fton nxënësit të japin mendimin mbi këtë fjalë duke u mbështetur në njohuritë e lëndës së historisë. Ata e lidhin fjalën me jetën në atë periudhë, veglat e punës, ushqimin, gjuetinë etj.

Ndërtimi i njohurive të reja: bisedë, punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon se çfarë paraqesin pikturat e shpellave dhe se çfarë domethënie kishte arti për njerëzit e paleolitit. Ai/a jo i orienton nxënësit/et të vëzhgojnë imazhet e veglave të punës dhe imazhet e skulpturës. Mësuesi/ja shpjegon teknikat e përdorura dhe domethënien e imazheve. Në drejtimin e mësuesit/es dhe duke parë imazhet e palafiteve, nxënësit diskutojnë se si ndryshoi mënyra e jetesës nga jeta në shpella në fshatra të organizuara, si dhe karakteristikat e këtyre ndërtesave. Ata/ato diskutojnë për enët qeramike dhe grafitet në neolit. Nxënësit informohen edhe gjetjet e periudhës së neolitit në Kosovë. Periudhë zhvillimi e njëjtë në të gjithë Ballkanin.

Duke u nisur nga lidhja e ngushtë që njerëzit e asaj periudhe kanë pasur me natyrën dhe kafshët, mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krijojnë logon e një kafshë në zhdukje.

Ai/a jo shpjegon se sot shumë kafshë janë në zhdukje, siç është ariu panda apo elefanti i bardhë dhe pyet: A dini ju kafshë të tjera që janë në rrezik zhdukjeje?

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të zgjedhin një kafshë që është në rrezik zhdukjeje dhe ta kthejnë në simbol për mbrojtjen e kafshëve, si simboli i elefantit të bardhë ose i ariut panda.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit/et diskutojnë për punën e kryer dhe për kafshët që kanë zgjedhur për t'i kthyer në simbol për mbrojtjen e kafshëve që rrezikojnë zhdukjen. Ata/ato diskutojnë për karakteristikat e artit në paleolit dhe neolit dhe për teknikat që artistët/et e asaj periudhe përdornin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të përfundojnë detyrën e nisur në klasë si një skic-ide.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 27

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Arte		Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Relacioni art-shoqëri Tema: Periudha historike		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Njeh vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore. Informohet rreth zhvillimeve bazë të historisë së artit duke dalluar disa nga këto periudha. Njeh disa nga përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike. Identifikon dhe njeh disa nga veprat më të njohura të artit.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor ose publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. II.7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike. III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar. IV.3. Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre. VI.1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artiste të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme. 1.2. Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj. 4.1. Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Arti në Mesopotami				
Fjalët kyçe: zigurati, arkitektura, argjila, skulptura, relievi, arti sumer, arti persian, shkrimi kuneiform.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - vëzhgon veprat e artit të periudhës së artit në Mesopotami; - zbulon karakteristikat e shprehjeve artistike dhe teknikat e përdorura në Mesopotami; - krijon duke u mbështetur në veprat e artit në Mesopotami; - shpreh mendimin e vet rreth veprave të artit të kësaj periudhe duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik.				

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Arti figurativ 6, fotografi me imazhe ilustruese mbi periudhën e artit në Mesopotami; mjete pune sipas dëshirës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja shkruan në tabelë “Mesopotamia”, i fton nxënësit të vëzhgojnë imazhin e qytetit në Mesopotami dhe të identifikojnë elementet e tij përbërës. Mësuesi/ja i fton nxënësit të diskutojnë duke u mbështetur në njohuritë e lëndës së historisë.

Ndërtimi i njohurive të reja: bisedë, punë individuale

Mësuesi/ja shpjegon lindjen e qyteteve në Mesopotami dhe kushtet klimaterike dhe gjeografike që mundësuat lindjen e tyre. Ata kuptojnë mënyrën e organizimit urbanistik të qyteteve lidhur edhe me pushtetin fetar dhe ekonomik. Mësuesi/ja shpjegon rëndësinë e materialit të argjilës në ndërtim dhe teknologjinë e përgatitjes së tij për ndërtim. Karakteristikat e artit në Mesopotami janë pjesë e rëndësishme e njohurive në këtë mësim.

Arti sumer fokusohet në lindjen e shkrimit kuneiform dhe përdorimin e materialeve të çmuara. Arti persian fokusohet në ndërtimet e arkitekturës madhështore.

Duke u mbështetur në zhvillimin e artizanatit në Mesopotami, kryesisht atë të stolive, mësuesi/ja i fton nxënësit të realizojnë një stoli duke përzgjedhur materialet e përshtatshme. Kjo ndihmon në njohjen më të thellë të teknologjisë artizanale të asaj periudhe.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit/et diskutojnë për punën e kryer dhe mënyrën se si e realizuan atë. Ata/ato çmojnë dhe vlerësojnë karakteristikat e artit në Mesopotami dhe për teknikat artistike që përdorëshin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të mbledhin të dhëna mbi artin në Mesopotami (artizanatin, skulpturën, arkitekturën etj.)

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 27

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Relacioni art-shoqëri Tema: Periudha historike		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Njeh vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore. Informohet rreth zhvillimeve bazë të historisë së artit duke dalluar disa nga këto periudha. Njeh disa nga përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike. Identifikon dhe njeh disa nga veprat më të njohura të artit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. II.7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike. III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar. IV.3. Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre. VI.1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artiste të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme. 1.2. Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj. 4.1. Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Arti egjiptian			
Fjalët kyçe: arti egjiptian, mastaba, piramida, sfinksi, piktura dhe skulptura egjiptiane, kanuni egjiptian.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon veprat e artit të periudhës së artit egjiptian; - zbulon karakteristikat e shprehjeve artistike dhe teknikat e përdorura në artin egjiptian; - krijon duke u mbështetur në veprat e artit egjiptian; - shpreh mendimin e vet rreth veprave të artit të kësaj periudhe duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Arti figurativ 6, fotografi me imazhe ilustruese të artit dhe arkitekturës egjiptiane; mjete pune si: letër vizatimi, laps, lapsa me ngjyra.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, kllasteri, bisedë

Mësuesi/ja shkruan në tabelë “Egjipti”, i fton nxënësit të vëzhgojnë imazhin e piramidave dhe të japin mendimet e tyre mbi Egjiptin dhe artin egjiptian. Mësuesi/ja i fton nxënësit të diskutojnë duke u mbështetur në njohuritë e lëndës së historisë. Nxënësit/et nxiten të flasin mbi njohuritë që kanë marrë në histori për Egjiptin dhe karakteristikat e shoqërisë egjiptiane të asaj kohe. Ata/ato diskutojnë për karakteristikat e piramidave, për çfarë shërbenin dhe me çfarë materiali janë ndërtuar.

Ndërtimi i njohurive të reja: bisedë, punë individuale

Mësuesi/ja tregon formën më të hershme të piramidave dhe më pas piramidat e Gizës. Mësuesi/ja shpjegon nga kush dhe pse janë ndërtuar piramidat e Gizës. Figura e sfinksit ilustron edhe më shumë rolin e faraonit në shoqërinë egjiptiane të kohës. Me ndihmën e imazheve që mësuesi/ja shfaq nxënësit/et diskutojnë për përmasat dhe karakteristikat e skulpturës egjiptiane.

Mësimi vazhdon me shfaqjen e imazheve të pikturës egjiptiane. Diskutohet për tematikat që përdornin artistët/et në pikturë, ku përdorej ajo, për ngjyrat dhe për mënyrën e paraqitjes të figurës së njeriut.

Mësuesi/ja shfaq skemën e paraqitjes së figurës së njeriut sipas kanunit egjiptian dhe i orienton të vëzhgojnë dhe diskutojnë për këto rregulla.

Ai/ajo i fton nxënësit/et të vëzhgojnë disa nga shpendët që paraqiten në pikturat egjiptiane, si dhe mënyrën realiste e me detaje të realizimit të tyre. Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et që, duke u mbështetur në këto imazhe, të krijojnë edhe ata/ato figurën e rosës (ose të ndonjë shpendi tjetër). Nxënësit duhet të kenë parasysh krijimin e teksturës së puplave dhe për këtë mësuesi/ja u rikujton njohuritë e marra te tekstura.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi, diagrami i venit

Pasi mbarojnë, nxënësit u çmojnë dhe vlerësojnë karakteristikat e artit egjiptian, temat e përdorura, materialet që përdornin skulptorët egjiptianë, mbi paraqitjen e figurës së njeriut, mbi funksionin e piramidës. Nxënësit krahasojnë ziguratin me piramidën duke parë karakteristikat e veçanta dhe të përbashkëtat. Ata/ato diskutojnë për punën e tyre, për mënyrën se si i realizuan shpendët, dhe i krahasojnë me pikturën egjiptiane.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të mbledhin të dhëna mbi artin egjiptian (artizanatin, skulpturën, pikturën, arkitekturën etj.).

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 29

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Relacioni art-shoqëri Tema: Periudha historike		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Njeh vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore. Informohet rreth zhvillimeve bazë të historisë së artit duke dalluar disa nga këto periudha. Njeh disa nga përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike. Identifikon dhe njeh disa nga veprat më të njohura të artit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. II.7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike. III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar. IV.3. Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre. VI.1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artiste të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme. 1.2. Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj. 4.1. Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Arti grek			
Fjalët kyçe: arti grek, periudhë e artit grek, tempull, stilet arkitektonike, teatër, skulpturë, vazo e pikturuar.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon veprat e artit të periudhës së artit grek; - zbulon karakteristikat e shprehjeve artistike dhe teknikat e përdorura në artin grek; - krijon duke u mbështetur në vazot e pikturuara të artit grek; - shpreh mendimin e vet rreth veprave të artit të kësaj periudhe duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, fotografi me imazhe ilustruese të artit dhe arkitekturës greke; mjete pune si: letër vizatimi, laps, lapsa me ngjyra ose flamastera Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë imazhin e tempullit grek, dhe i nxit të identifikojnë cilës kulturë i përket. Mësuesi/ja i nxit nxënësit të flasin mbi njohuritë që ata/ato kanë marrë në histori për Greqinë antike: Si quheshin qytetet greke, për ndërtesat karakteristike, për Akropolin. Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, bisedë, punë individuale Mësuesi/ja shpjegon se arti grek ndahet në katër periudha artistike sipas karakteristikave përkatëse që shfaq ky arti në secilën periudhë. Mësuesi/ja shpjegon se tempulli grek ishte shtëpia e perëndive dhe i fton të gjejnë elementet arkitektonike më të dukshme të tempullit. Mësuesi/ja shfaq tri llojet e shtyllave, të cilat përcaktojnë tri stilet e arkitekturës dhe i nxit nxënësit të zbulojnë karakteristikat e secilës. Teatri grek është një ndërtesë e rëndësishme e arkitekturës dhe e qytetërimit grek. Mësuesi/ja i orienton nxënësit të gjejnë pjesët kryesore të ndërtesës dhe të diskutojnë për rolin që kishte teatri. Veprimtaria mësimore vazhdon me shfaqjen e skulpturave të disa periudhave të artit grek. Mësuesi/ja shpjegon materialin me të cilin punoheshin këto skulptura dhe funksionin që luante skulptura në artin grek. Vazot greke janë dëshmi e pikturës greke. Shfaqen vazot e periudhës gjeometrike, vazot me figura të zeza dhe sfond të kuq dhe anasjelltas. Nxënësit inkurajohen të identifikojnë karakteristikat e tyre. Nxënësit/et nxiten të krijojnë, duke u mbështetur te motivet gjeometrike, te format e larmishme dhe te ngjyrat karakteristike të vazove greke (jepen shembuj për këtë). Ata/ato vizatojnë në fletë, një vazo dhe e dekorojnë me motive gjeometrike të vazove greke. Ata/to përzgjedhin një formë sipas dëshirës. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi Pasi mbarojnë punën, nxënësit çmojnë dhe vlerësojnë karakteristikat e artit grek, mbi arkitekturën, mbi skulpturën dhe funksionet e saj, mbi teatrin grek, mbi pikturën e vazove. Ata/ato diskutojnë për punën e tyre, për mënyrën se si i realizuan vazot e tyre duke i krahasuar me ato greke.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet: - në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore; - në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e; - në mënyrën e realizimit të detyrës; - në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të mbledhin të dhëna mbi artin grek (skulpturën, pikturën, arkitekturën etj.) për të shtuar njohuritë e tyre mbi këtë periudhë të historisë së artit.
REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 30

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Arte		Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Relacioni art-shoqëri Tema: Periudha historike		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Njeh vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore. Informohet rreth zhvillimeve bazë të historisë së artit duke dalluar disa nga këto periudha. Njeh disa nga përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike. Identifikon dhe njeh disa nga veprat më të njohura të artit.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. II.7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike. III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar. IV.3. Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre. VI.1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artiste të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme. 1.2. Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj). 4.1. Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse.				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Arti romak				
Fjalët kyçe: art romak, Koloseu, ujësjellësit romakë, harku i triumfit, domus, skulpturë dhe pikturë romake, mozaik.				
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon veprat e artit të periudhës së artit romak; - zbulon karakteristikat e shprehjeve artistike dhe teknikat e përdorura në artin romak; - krijon duke u mbështetur në veprat e artit romak; - shpreh mendimin e vet rreth veprave të artit të kësaj periudhe duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik.				

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Arti figurativ 6, fotografi me imazhe ilustruese të artit dhe arkitekturës romake; mjete pune si: letër vizatimi, laps, lapsa me ngjyra ose flamastera.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë imazhin Koloseut si simbol i qytetërimit romak. Orientohen nxënësit/et të flasin për qytetërimin romak duke u mbështetur në njohuritë e marra në histori. Ata/ato diskutojnë se ku u zhvillua qytetërimi romak dhe çfarë ndërtese ishte Koloseu dhe për çfarë shërbente.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, bisedë, punë individuale

Mësuesi/ja shfaq imazhe nga arkitektura romake si: ujësjellës, harkun e triumfit, dhe shpjegon karakteristikat e tyre arkitektonike dhe funksionale. Mësuesi/ja shpjegon mënyrën e organizimit të qytetit në Romë, duke treguar funksionet që luanin godinat e gjetura nga arkeologët/et. Ndarjen në shtresa të qytetarëve romakë e tregojnë edhe banesat e destinuara veç për të pasurit dhe veç për popullin e thjeshtë. Skulpturat romake paraqisnin fitoret në beteja dhe triumfin e gjeneralëve romakë. Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e skulpturës romake dhe si ajo u mbështet tek arti etrusk dhe grek. Veprimtaria vazhdon me shfaqjen e pikturave të Pompeit dhe diskutohet mbi karakteristikat e tyre.

Mozaiku është një teknikë shumë e përdorur nga romakët. Diskutohet mbi përdorimet e saj dhe materiali me të cilin punohej. Duke u nisur nga motivet e mozaikëve romake nxënësit/et nxiten të krijojnë një dekoracion të thjeshtë për dysheme në fletën e tyre. Gurët mund të imitohen me katrorë të vegjël të ngjyrosur me lapsa ose flamastera.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit çmojnë dhe vlerësojnë karakteristikat e artit romak, mbi arkitekturën, skulpturën dhe karakteristikat e saj, mbi amfiteatrin, pikturat murale dhe mozaikun. Ata/ato diskutojnë për punën e tyre, mënyrën se si e realizuan idenë e një mozaiku dekorativ për dysheme, duke bërë krahasimin me shembujt e mozaikëve romakë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të mbledhin të dhëna mbi artin romak (skulpturën, pikturën, arkitekturën etj.) për të shtuar njohuritë e tyre mbi këtë periudhë të historisë së artit.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 31

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Relacioni art-shoqëri Tema: Periudha historike		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Njeh vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore. Informohet rreth zhvillimeve bazë të historisë së artit duke dalluar disa nga këto periudha. Njeh disa nga përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike. Identifikon dhe njeh disa nga veprat më të njohura të artit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkruar, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. II.7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike. III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar. IV.3. Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre. VI.1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artiste të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme. 1.2. Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj. 4.1. Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Qytetet antike në Kosovë dhe Shqipëri			
Fjalët kyçe: qytetet antike Butrinti, Apolonia, Durrësi, Municipium d.d, Municipium Ulpiana, arkitektura, skulptura, mozaiku			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon veprat e artit dhe arkitekturën e qyteteve antike në Shqipëri dhe Kosovë; - zbulon karakteristikat e shprehjeve artistike dhe teknikat e përdorura në artin e qyteteve antike në Shqipëri dhe Kosovë; - vlerëson objektet arkeologjike të qyteteve antike në Shqipëri dhe Kosovë si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore; - krahason objektet arkeologjike të qyteteve antike në Shqipëri e Kosovë me kulturat Greke e Romake.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Arti figurativ 6, fotografi me imazhe ilustruese të artit dhe arkitekturës së qyteteve antike në Shqipëri dhe Kosovë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë imazhet e materialeve fotografike të ndërtesave më karakteristike të qyteteve antike. Nxënësit ftohen të tregojnë se kujt qyteti i përkasin këto objekte, nëse i kanë vizituar ndonjëherë, apo kanë informacion për to. Duke treguar teatrin e Butrintit mësuesi/ja i orienton të gjejnë ngjashmërinë me teatrot greke.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja shpjegon se qytetet bregdetare Butrint, Apolonia, Durrësi, edhe pse i përkasin kulturës ilire, në shekullin VII p.e.s. u ndikuan nga kultura greke dhe më pas nga ajo romake si rrjedhojë e kolonizimit të tyre. Po ashtu në shekullin I e.s. pas pushtimit të plotë të Ilirisë, romakët vendosën sistemin e tyre administrativo-ushtarak edhe në Dardani, gjë e cila solli përhapjen e qytetërimit dhe kulturës romake. Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e ndërtesave më të njohura të Butrintit, Apolonisë, Durrësit, nëpërmjet imazheve. Mësuesi/ja thekson ndikimin grek dhe romak në këto qytete duke iu referuar gjithmonë imazheve. Mësuesi/ja shfaq imazhet e skulpturave të gjetura në këto qytete dhe shpjegon funksionin e tyre të lidhur ngushtë me arkitekturën, si dhe tematikën e tyre. Veprimtaria vazhdon me shfaqjen e mozaikëve si pjesë e teknikave artistike të lëvruara në këto qytete. Shpjegohen karakteristikat e tyre. Imazhet e gjetjeve arkeologjike në qytetet antike në Kosovë shoqërojnë shpjegimin e mësuesit/es mbi karakteristikat e tyre urbanistike dhe të ndërtesave të gjetura në to. Mozaikët e periudhës së antikitetit të zbuluara në territorin e Kosovës konsiderohen mjaft të veçantë për nga vlerat artistike që paraqesin e po ashtu edhe skulptura. Mësuesi/ja shfaq disa foto të parqeve arkeologjike në Shqipëri dhe Kosovë dhe udhëzon nxënësit se çfarë duhet të kenë parasysh kur vizitojnë këto parqe (si të organizuar me shkollën ashtu edhe me prindërit).

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Në fund të orës së mësimi, nxënësit diskutojnë mbi ndikimin që patën qytetet antike në Shqipëri dhe Kosovë nga kultura greke dhe romake duke bërë krahasime:

mbi monumentet më të rëndësishme në këto qytete; mbi skulpturën dhe mozaikun;

ata/ato shprehin mendimin e tyre për rëndësinë e parqeve arkeologjike dhe diskutojnë se çfarë duhet të kenë parasysh gjatë vizitës në këto parqe.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënëses/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të mbledhin të dhëna mbi artin e qyteteve antike në Kosovë dhe Shqipëri për të shtuar njohuritë e tyre mbi trashëgiminë kulturore.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 32

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Relacioni art-shoqëri Tema: Periudha historike		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Njeh vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore. Informohet rreth zhvillimeve bazë të historisë së artit duke dalluar disa nga këto periudha. Njeh disa nga përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike. Identifikon dhe njeh disa nga veprat më të njohura të artit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkruar, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. II.7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike. III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar. IV.3. Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre. VI.1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artiste të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme. 1.2. Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj. 4.1. Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Arti islam			
Fjalët kyçe: arti islam, arkitektura, arabeska, kaligrafi, dekoracion.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - vëzhgon veprat e artit islam; - zbulon karakteristikat e shprehjeve artistike dhe teknikat e përdorura në artin islam; - krijon duke u mbështetur në kaligrafinë dhe dekoracionet islame; - shpreh mendimin e vet rreth veprave të artit të kësaj periudhe duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, fotografi me imazhe ilustruese të artit dhe arkitekturës islame; mjete pune sipas dëshirës			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë imazhe të arkitekturës islame (xhami me vlera estetike) dhe i pyet për çfarë shërbejnë dhe çfarë përfaqësojnë. Nxënësit japin shembuj të kësaj arkitekture pranë vendeve të tyre të banimit.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, bisedë, hulumtim i lirë

Mësuesi/ja shpjegon ku lindi, kur dhe si u përhap arti islam. Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e arkitekturës dhe të qytetit islam dhe rëndësinë e xhamisë në këtë qytet.

Sipas mendimit islam, art nuk duhet të imitojë natyrën, pasi do të ndryshonte veprën e krijuar nga Zot. Në këtë mënyrë filloi të mbizotërojë prirja për të paraqitur imazhe të stilizuara dhe abstrakte. Imazhet shoqërojnë shpjegimin e këtyre njohurive. Mësuesi/ja shpjegon se arti islam pati ndikimin e tij edhe në trojet shqiptare. Nëpërmjet shembujve të ndryshëm, nxënësit njihen kryesisht me arkitekturën e xhamive që përbëjnë edhe vlera të trashëgimisë kulturore dhe karakteristikat e tyre.

Nxënësit ftohen të vëzhgojnë disa shembuj të kaligrafisë si një shembull shumë interesant të artit islam. Mësuesi/ja i orienton të ushtrohen në riprodhimin e shenjave dhe t'i shoqërojnë ato me motive dekorative nga arti islamik.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë, nxënësit çmojnë dhe vlerësojnë karakteristikat e artit islam, mbi arkitekturën dhe artin dekorativ. Ata/ato diskutojnë për punën e tyre, mënyrën se si e realizuan detyrën mbi kaligrafinë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të mbledhin të dhëna mbi artin romak (skulpturën, pikturën, arkitekturën etj.) për të shtuar njohuritë e tyre mbi këtë periudhë të historisë së artit.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 33

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Relacioni art-shoqëri Tema: Vizita dhe ngjarje artistike		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Viziton institucione të ndryshme të artit si muze, galeri, qendra kulturore, vizita virtuale në internet në faqe të ndryshme etj. Viziton atelie dhe studio të artistëve, dhe ndanë eksperiencat me artistët profesionist ¹ .	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit. II.6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim. III.8. Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu). IV.3. Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre. V.5. Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porositë apo kërkesën e tyre vizuale. VI.8. Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.3. Njohin ngjarje, institucione, e zhvillime artistike të rëndësishme të periudhave të ndryshme historike në kontekste të ndryshme shoqërore (lokal, regjional, kombëtar, global etj.). 4.3. Çmojnë veprat e trashëgimisë kulturore-popullore në ambientin ku jetojnë.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Arkeologjia, restaurimi dhe muzeu			
Fjalët kyçe: arkeologji, arkeolog, restaurim, restaurator, muze arkeologjik, park arkeologjik.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zbulon përvoja dhe profesione që lidhen me artin dhe trashëgiminë kulturore; - ndjek rregullat e etikës gjatë vizitës në muze; - vlerëson rolin edukues dhe komunikues që luan muzeu arkeologjik nëpërmjet koleksionit të veprave dhe objekteve të artit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ 6, fotografi që ilustronë gërmimet arkeologjike, restaurimin e objekteve dhe fotografi nga muzeu arkeologjik.			

¹ Në bazë të mundësive që çdo shkollë ka dhe vendndodhjes së saj mund të organizojë vizita në studio të artistëve, zonës, në artizanë, muze apo qendra dhe objekte të trashëgimisë kulturore.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kllasteri, bisedë

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën “Muze” dhe i fton nxënësit të japin mendimin e tyre rreth kësaj fjale. Nxënësit/et orientohen nëpërmjet pyetjeve: Çfarë dini ju për muzeun? A keni vizituar ndonjë muze? Çfarë objektesh ruan dhe ekspozon një muze? Sa lloje të muzeve njihni? Po në muzeun arkeologjik keni qenë ndonjëherë?

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, bisedë

Mësimi vijon me orientimin për të vëzhguar imazhe që tregojnë mbi gërmimet arkeologjike dhe arkeologët në momentin e punës. Nxënësit/et nxiten të vëzhgojnë me vëmendje fotot dhe u shpjegohet roli i shkencës së arkeologjisë dhe të arkeologut. Mësuesi/ja shpjegon që objektet shpesh gjenden të dëmtuara ose kanë nevojë për përkujdesje dhe pyet nxënësit/et nëse kanë ngjitur ndonjëherë vazo të thyer dhe si. Ai/ajo shfaq fotografinë e një restauruesi që ngjir një objekt. Kjo është pikërisht puna e restauruesit.

Veprimtaria mësimore vazhdon me diskutimet mbi muzeun arkeologjik, mbi rëndësinë e tij edukative dhe mbi mënyrën e ekspozimit të objekteve për të komunikuar më mirë me vizitorët. Më pas, mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të flasin për rregullat që duhen ndjekur gjatë vizitës në muze, duke u nisur nga përvojat e tyre. Ai/ajo i orienton nxënësit/et me rregullat më të rëndësishme që duhen ndjekur gjatë vizitës në muze.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Në fund të orës së mësimi, nxënësit:

flasin për muzeun arkeologjik, objektet që ekspozohen dhe mënyrën e ekspozimit;
diskutojnë dhe vlerësojnë profesionet e arkeologut dhe të restauratorit;
shprehin mendimin e tyre mbi rolin edukues të muzeut dhe çfarë duhet të kenë parasysh gjatë vizitës në muze.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të vizitojnë sa më shumë muze arti, qendra kulturore, punishte artizanati apo studio të artistëve.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 34

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik Tema: Vlerësimi i veprave artistike ³		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Analizon punimet, debaton për trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit. Analizon dhe vlerësojë krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor ose publi- cistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. II.7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike. III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. III.7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar. IV.3. Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre. VI.1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.2. Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj. 4.1. Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Krahasojmë teatrin grek me amfiteatrin romak			
Fjalët kyçe: amfiteatri romak, teatri grek.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - vëzhgon imazhe të ndryshme të teatrove grekë dhe amfiteatrove romakë; - nxjerr të dhëna me shkrim mbi karakteristikat e teatrit grek dhe amfiteatrit romak; - krahason dhe rendit karakteristikat e veçanta dhe të përbashkëta të teatrit grek dhe amfiteatrit romak.			

1 Ky planifikim është një shembull i realizimit të një ore mësimore që ka lidhje me konceptin e çmuarjes dhe të vlerësimit. Ky proces është pjesë e integruar e procesit mësimor të çdo ore për mund të realizohet edhe si njësi mësimore më vete ku nxënësit mund të krahasojnë dy vepra/objekte arti nga historia ose dy punime të tyre.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Arti figurativ 6, imazhe ilustruese të teatrove greke dhe amfiteatrove romake; të dhëna me shkrim.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: kujtesa pamore, bisedë

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë imazhin e Koloseut si simbol i qytetërimit romak dhe teatrin grek dhe të gjejnë dallimet. Ndërkohë ata janë njohur me të dyja këto ndërtesa të rëndësishme, por për të bërë një analizë krahasuese më të thelluar nxënësit kanë nevojë për material shtesë.

Ndërtimi i njohurive të reja: kujtesa pamore, hulumtim i orientuar, punë në grup

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të ndahen në grupe. Çdo grup duhet të hulumtojë materialet që ka marrë me vete mbi të këto dy arkitektura. Ata duhet të nxjerrin karakteristikat e veçanta për secilën prej tyre e më pas nëpërmjet krahasimit të gjejnë ato të përbashkëta. Mësuesi/ja i orienton në cilat pika duhet të mbështeten për kërkimin e tyre dhe formatin e diagramit të venit për ta paraqitur atë. Anëtarët ndajnë detyrat dhe fillojnë nga puna.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diagrami i venit, diskutimi

Pasi mbarojnë, sistemojnë informacionin sipas kërkesës në formatin e diagramit të venit dhe e kanë shoqëruar me imazhe fotografike. Nxënësit/et çmojnë dhe vlerësojnë karakteristikat e veçanta të teatrit grek dhe amfiteatrit romak dhe karakteristikat e tyre të përbashkëta. Gjithashtu, grupet çmojnë dhe vlerësojnë punën e bërë prej tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra vendoset nga mësuesi/ja.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 35

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	Lënda: Arti figurativ	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Relacioni art-shoqëri Tema: Ekspozita dhe aktivitete kulturore		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë, Galeri e komunitet. Vëren, përjeton, analizon, çmon, vlerëson e gjykon punën artistike në mënyrë analitike-kritike përmes punimeve individuale, grupe brenda dhe jashtë klasës, ekspozitave të organizuara shkollë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit. II.6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim. IV.3. Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre. 14. Përkujdeset për shëndetin fizik dhe mendor gjatë aktivitetit fizik dhe sportiv me karakter rekreativ dhe garues, por edhe duke respektuar të tjerët gjatë garës apo lojës. 15. Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale. VI.6. Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit. VI.8. Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.3. Njohin ngjarje, institucione, e zhvillime artistike të rëndësishme të periudhave të ndryshme historike në kontekste të ndryshme shoqërore (lokal, regional, kombëtar, global etj.) 1.1. Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, PowerPoint prezantim e forma të tjera shprehëse. 1.2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ekspozita e fundvitit			
Fjalët kyçe: ekspozitë, përzgjedhje e punimeve, vendosje dhe ekspozim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - zhvillon aftësitë krijuese dhe ndërvepruese; - komunikon në mënyrë efektive me shokët dhe shoqet e klasës; - përdor fjalorin e përshtatshëm artistik mbi gjuhën pamore, teknikat dhe historinë e artit; - diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për ndarjen e punës; - shpreh mendimin e tij/saj për rezultatet e arritura në realizimin e ekspozitës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: krijimet e nxënësve/eve të realizuara gjatë vitit shkollor në të gjitha tematikat; mjete të tilla si: tabakë letre, ngjitës, gërsërë, pineska etj.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuha dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Njohja e kulturave, Bashkëjetesa dhe bashkëpunimi.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË
E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: bisedë

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të krijojnë një ekspozitë me punimet e tyre të krijuara gjatë vitit shkollor. Aty ata/ato do të shfaqin punën dhe ecurinë e tyre në lëndën e artit figurative gjatë vitit shkollor. Fillimisht, mësuesi/ja i fton nxënësit të gjejnë një titull për ekspozitën dhe i orienton të diskutojnë për mënyrën se si ndërtohet një ekspozitë dhe të tregojnë për përvojat e tyre në ekspozimin e punimeve.

Ndërtimi i njohurive të reja: bisedë, punë grup

Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et se për të hapur një ekspozitë të përbashkët, duhet të punojnë në grupe. Mësuesi/ja e ndan klasën në katër grupe dhe i orienton për ndarjen e punës. Një grup së bashku me mësuesin/ en do të përzgjedhë punët më të mira për secilën tematikë, në mënyrë që çdo nxënës/e të jetë pjesëmarrës/e i/e barabartë në ekspozitë. Është mirë që të ketë punime nga secila tematikë.

Grupi i dytë i ndan punimet sipas tematikave dhe i kalon te grupi i tretë, i cili bën vendosjen e punëve në tabakët e letrës. Grupi i katërt përcakton dhe ndan hapësirat ku do të vendosen punimet dhe si do të vendosen.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: diskutimi

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et flasin, diskutojnë për ekspozitën e tyre, për njohuritë që kanë marrë gjatë këtij viti shkollor në lëndën e artit pamor dhe se si i përdorën ato në krijim. Ata/ato diskutojnë për mënyrën e bashkëpunimit dhe rezultatin e ekspozitës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me njësinë e re mësimore;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyra vendoset nga mësuesi/ja.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

REFERENCA

- Kurrikula lëndore/programi mësimor: *Art figurativ 6*; Republika e Kosovës, gusht, 2018
- Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës, Fusha e Kurrikulës Artet; Instituti Pedagogjik i Kosovës; Republika e Kosovës; Mars 2014
- Angela Wenzel; *13 Art Tehniques Children Shoud Know*; PRESRTEL, Munihi-London-New York, 2013
- *Guidë arkeologjike e Kosovës*; Milit Berisha; Botues: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Instituti Arkeologjik i Kosovës, Prishtinë 2012
- Edmund Burke Feldman; *Varieties of visual experience, Art as Image and Idea*; New York, second edition
- Rudolf Arnheim; *Arte e percezione visiva*; Feltrineli, 1994
- Ferid HUDHRI; *Albania through art*; Donika Bardha Albanian Arts Foundation, Tirana, 2007
- Edward Lucie-Smith; *ARTI VISIVE del XX SECOLO*; Konemann, 2000
- Alan Pipes; *Foundation of Art and Design*; Laurence King Publishing, 2013
- Muzafer Korkuti; *Arti shkëmbor në Shqipëri*; Instituti i Arkeologjisë, TIRANË 2008

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:741(072)(075.2)

Nini, Silvana

Art figurativ 6 : libër për mësuesin/en : për klasën e 6-të të arsimit
9-vjeçar / Silvana Nini, Faton Aliu. - Prishtinë : Pegi, 2024. - 104 f. :
ilustr. ; 20.7x28 cm

1. Aliu, Faton

ISBN 978-9951-843-29-4